

INTERVISTË ME BURHAN KAVAJËN

Prishtinë | Data: 30 tetor, 2020

Kohëzgjatja: 163 minuta

Të pranishëm:

1. Burhan Kavaja (I intervistuari)
2. Anita Susuri (Intervistuesja)
3. Korab Krasniqi (Intervistuesi)
4. Renea Begolli (Kamerë)

Simbolet e komenteve në transkriptë te komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

Pjesa e Parë

Anita Susuri: Nëse mundeni me u prezantu edhe me na tregu diçka për prejardhjen e ju.

Burhan Kavaja: Quhem Burhan Kavaja, jom i lindun me 9 maj, 1943-shin. Zyrtarisht jom i shkruar me 20 maj, për arsye se baba ish vonu me shku me më lajmru edhe kur ka shku i kanë thonë, “Je vonu shumë. Duhet me të dënu”, thotë, “Atëherë shkruar me 20 maj”. Prej prindëve Hajrullahit dhe Xhevahirës. Hajrullahi ka qenë zejtar, rrobaqepës, i cili plot 65 vjet e ka pasë dyqanin e vet. Bilem, atëhere kur dojshim që ai me nejt në shpi, mos me shku në punë, thojke, “Me më dhonë ari nuk shkoj pa e çelë dyqanin”. Ka qenë një punëtor shumë i madh, i zellshëm, zejtar, shumë i ndershëm. Nana amvise, e cila na ka rritë katër djel, e tri vajza. Nji vajzë e saj Shivizati, vdes 21 vjeçare. Ne të gjithë tjerët të shkollum, të lamë, të pastrum, prej nanës Xhevahire, ja dijmë të gjithë për nder. Na katër vllazën edhe një motër jena gjallë.

Osht’ shumë interesante se lëvizjet e familjes Kavaja, kanë qenë prej Kavajës në Prizren, Topxhiu, Qerkaxhiu, mandej kur kanë shku në Gjakovë i kanë thirrë Kovaçi, kur kanë ardh ‘42-shin, ‘43-shin në Prishtinë i kanë thirrë Mustafa, në emër të babgjyshit. Pasi patën insistu që me shkru Mustafiq, baba duke u nis nga prejardhja vendosi që me e shkru Kavaja. Në vitin 1951, në fletën zyrtare të Jugosllavisë u ndërru mbiemri prej Mustafës në Kavaja. Prej atëhershit e mbajmë këtë emër. Unë si inzhinjer i diplomum kom punu në shumë vende, ma vonë e paraqes edhe historinë e punës time. Shkollimin fillor...

Anita Susuri: Më falni pastaj vazhdojmë te shkollimi, deshta edhe pak te prindët me u ndal. Baba ju ku e ka pasë dyqanin?

Burhan Kavaja: Baba jem e ka pasë dyqanin në Mitrovicë, në afërsi të tregut të Mitrovicës, një kohë shumë të gjatë. Thashë, përmi 65 vjet që ka majt dyqan aty edhe atëherë kur s’ mujke me dalë, shkojke. Kohën e fundit nja 15-16 vjet të fundit të jetës tina ka udhëtu prej Prishtinës pasi që gjithë vllaznit u shpërngulëm prej Mitrovicës në Prishtinë edhe ai ka rru me vllaun tim të tretin Ramadanin. E ka pasë një jetë në harmoni, një jetë e cila pikërisht me vizionet e tina ka qenë ajo që ka kontribu një

harmonije. Asnjëherë nuk ka insistu që të jena kojshi, bile përkundrazi ka kërku secili prej neve me qenë në katër qoshet e qytetit, që mos me qenë afër.

Mirëpo, ajo s'ka qenë arsy që çdo të dille mëngjesin e kena hongër bashkë. Pasi kena edhe fenë muslimane, ne asnji Bajram nuk e kena bo ndaras derisa kanë qenë prindërit gjallë, gjithmonë së bashku. Mirëpo, atë ditë ose dilleve kur ishim për mëngjes së bashku u bojke si me qenë darsëm se secili e kish familjen e vet, secili i kish obligimet e veta, e kishim kajherë ka një burim për përmirësimin e rrogave, një pastrim kimik në Mitrovicë, me të cilin kishim të hyra edhe ato u ndajshin në katër vena të njejta. Edhe pikërisht ajo na mundësojke që me pasë një jetë solide, pa pengesa. Mirëpo, shkollimi s'ka qenë bash pa pengesa.

Shkollën fillore edhe të mesme e kom kry në Mitrovicë, atëherë u hap Shkolla e Naltë Teknike vazhdova. Studenti numër një me indeks në Shkollën e Naltë Teknike, por jo edhe i pari me kry, ma vonë e kom kry. Mirëpo, ajo ma mundësoi që mandej me qenë student i Univerzitetit të Beogradit në Beograd, ku fakulltetin e kryjta gjashtë muj para afatit. Kishte problem me diplomu u dufke leja e veçantë për arsye se unë nuk kisha nevojë me regjistru semestrin e nantë për me diplomu. Mirëpo, të gjitha ato u rregullun edhe me një sukses të shkëlqyeshëm diplomova në Beograd.

Shkollën e tretë e kom kry në Zagreb, doktoraturën e kom pasë të pregaditne... osht' interesante du me ju tregu, nuk e mbrojta. Për arsye se e pata përgaditë një lami të veçantë Teknika e Sigurisë në Institutin e Punës i cili ishte në Nish. Para se me mbrojt diplomën, ata më kushtëzun që t'ju jepi një projekt dikun afër dymdhetë mijë marka që të jenë pare për Institutin. Unë isha në atë kohë drejtor gjeneral në Han të Elezit, në cementore edhe m'u duke diçka absurde që me ju dhonë dymdhetë mijë euro për një projekt pasi para saj e patëm themelu Institutin e Punës në Obiliq. E unë isha ndër ata që pata kontribu në themelimin e atij Instituti e tash me ju dhonë atynve dymdhetë mijë euro m'u doke pak diçka absurde edhe ashtu që ata ma anulun doktoraturën edhe prej atëhershit nuk doktorova mo. Mirëpo, kjo nuk ka qenë arsye që veprimtaritë tjera arsimore, shkencore dhe inzhinjerike mos me i vazhdu. Ju kisha tregu pak për historinë e punës.

Anita Susuri: Para se me vazhdu me historinë e punës...

Burhan Kavaja: Po.

Anita Susuri: Po du me ju pyet për një pjesë është shumë me rëndësi, ju keni lind në vitin '43 ka qenë Lufta e Dytë Botërore domethonë, edhe ju a keni kujtime prej fëmijërisë domethonë si ka qenë koha pas përfundimit të luftës? Si ka qenë ambijenti ku jeni rritë, ku keni luft ose ku jeni shkollu? Se ka qenë një luftë kogja e vështirë edhe dërmuse e çfarë pasoja ka lonë për shembull në rrethin ku ju keni jetu? Edhe në familjen e ju?

Burhan Kavaja: Po, po, pasi që kam qenë praktikisht fëmijë i lindun në luftë, se atëherë ka qenë ende lufta. Më kujtohet shumë mirë se baba në atë kohë... qysh edhe ai më tregojke se unë si një vjeçar, dy vjeçar nuk i mbaj në mend të gjitha ato, maçinën e vet për qepje e ka bajt në Zhabar, një fshat afër Mitrovicës edhe aty ka punu deri sa u shliu Mitrovica, me 23 nandor '44-shin. Mandej komplet fëmijëria ime ka qenë e lidhun me aktivitete të prindit (buzëqeshë). Si fëmijë i vogël çdo ditë shkojsa

në dyqan me i ndihmu babës edhe më kujtohet si sot si pesë-gjashtë vjeçar, kur hypsha me ni sandëk me i ndihmu babës me hekuros të gjitha ato tesha që i kish kep ai. Domethonë, nuk kom pasë fëmijëri me lojna, nuk kom pasë fëmijëri me naj dëfrim të veçantë.

I vetmi dëfrim i veçantë në atë kohë kanë qenë të ashtuquajtura *tačkicat* kanë qenë kupona të cilat u dhojshin për ushqim, në ato kupona kishte edhe kupona për çokollada. Qajo ka qenë dëfrimi, ushqimi ma i mirë në atë kohën e fëminisë. Jo rrallë ka ndodhë në atë kohë që nuk kishte punë baba që me pasë edhe gjumin pa e konsumu darkën. Mirëpo, meqenëse ishëm shumë fëmijë, disi krejt ato i shifshim me nji farë harmonije, hareje edhe (qeshë) kur s’kish çka me ngronë dishum m’u disponu edhe me kalu natën pa vështirësi.

Jom i regjistrum si pesë vjeçar në shkollë. Atëherë ka qenë shkolla gatimore, si sot më kujtohet e kom pasë mësuse, nji edukatore e cila... kurrë, kurrë nuk e harroj. Ka qenë motra e Enis Preshevës, Presheva, e cila më pat dhonë mësim në klasën e parë. Mas asaj e kam pasë Vilma Shkrelin edhe kështu që shkollën fillore e kalova me do pedagoge jashtëzakonisht të mira. Ato në atë kohë nuk e kishin arsimimin si sot që e kanë pedagoget, mirëpo ishin për neve çdo gjë {tund kokën}. Derisa nuk e msojshim bukurshkrimin, shkrimin me të cilin duhet bukur me shkru nuk na lojshin me kalu klasën (buzëqeshë).

Kështu, e kryva tetëvjeçaren me do pedagogë që kanë qenë me shumë entuziazëm, dëshirë, aspiratë për gjeneratat e reja shqiptare që të shkollohen, sa që ju di për nder. Edhe ato gjenerata krijun nji, kisha thonë rini në Mitrovicë, e cila ma vonë në supet e veta i barti të gjithë të arriturat tekniko-teknologjike, arsimore e kulturore.

Anita Susuri: Qysh e kujtoni ju Mitrovicën në atë kohë, në çfarë gjendje ka qenë Mitrovica?

Burhan Kavaja: (psherëtimë e thellë) Mendoj se Mitrovica ka qenë nji qytet i veçantë. Me nji industri, miniera, shkritore edhe objekte të uzinave, të cilat nuk i kishte asnjë qytet tjetër në Kosovë. Faktikisht ka qenë qytet i minatorëve. Si fëmijë e di, kur u marshin rrogat në “Trepçe”, për arsye se ato dy-tri ditë ishte një rrëmujë e paparë për me u siguru ose me gjana ushqimore, ose me veshmbathje për arsye se shumica prej tyne punojshin në “Trepçe”. “Trepça” ka qenë nji qytet i cili ka përjetu, të gjitha ato gjana nga kolonitë angleze. Ka pasë bazenet, fushat e tenisit, sallat për ballo, ka pasë në të gjitha këto rrethe si në Stari Trg në Zveçan, po edhe në Mitrovicë.

Aty ka qenë rinija kosmopolite dhe kanë qenë të gjithë ata të cilët bilem fillimisht nuk kanë pasë ngarkesa nacionaliste. Ma vonë fillun këto ngarkesa, a është e vërtetë se në atë kohë, bilem prej statistikave që i kom pa ma vonë, 73 përqind në “Trepçe” dhe në organizata tjera prodhuse kanë qenë të kombësisë sërbe. Me ndërrimin e kësaj strukture u krijun xhelozitë, u krijun situata të padurushme që e morrën edhe kahjen e nacionalizmit.

Anita Susuri: Për këtë periudhën që po thoni ka pasë salla të ballove e këto, po flasim vitet, deri vitet ‘50-ta, a po?

Burhan Kavaja: Po flasim për vitet '47-ta, '48, '50 edhe ma vonë '60-ta. Anglezët i kanë lonë fushat e tenisit edhe bazenin kur kanë ikë prej këtuhit. Domethonë, '44-'45, veç edhe gjermanët që i kanë pasë, i kanë trashëgu ato, kanë ditë me i shfrytëzu. Anglezët kanë punu në “Trepçe” prej vitit '48 [‘28] deri në '41-shin. Në '41-shin patën ardhë gjermanët...

Korab Krasniqi: '28 deri '41 a po? 1928 deri '41.

Burhan Kavaja: Po. T’ju tregoj një epizodë (buzëqeshë) ndoshta pakëz edhe historike. Pas burgosjes e ato isha në Angli dhe shova në parlamentin anglez kërkova që, “Pse ju mos t’i merrni aksionet e juja që i keni në ‘Trepçe?’” Drejt me thonë ma tepër dojsa që ato t’ju takojnë anglezëve se sërbeve. Parlamentarët anglezë thanë, “Zotëri do t’i shiqojmë këto edhe po e lojmë një dy ditë, mandej takohem”. Mas një dy dite u takum, po më thojnë, “Ne atje nuk kena kurrfarë të ardhuna. S’kena kurrfarë kapitali tonë, për arsy se ai në vitet '50-ta osht’ pagu nga ish-Jugosllavia”.

Ma vonë pata rast me lexu literaturë që Titoja kishte bo pagesën e gjitha atyne obligimeve të anglezëve, kuptohet me presion edhe ata kishin heqë dorë prej aksioneve të veta që i kanë pasë në “Trepçe”, krejt i kish pasë pagu Jugosllavia atëhere. E mu e para herë m’u dha në parlament, megjithëse unë kam qenë në “Trepçe”, e kam qenë në organe, por kurrë s’e kom pa historiatin e mbulimit të shpenzimeve të aksioneve që i ka bo Jugosllavia për “Trepçën”.

Anita Susuri: Deshta edhe njëherë me ju pyt për Mitrovicën çfarë qyteti ka qenë në pamje për shembull, pas Luftës së Dytë Botërore, a u vrejt që ka pasë dëmtime apo si e kujtoni ju?

Burhan Kavaja: Pytje shumë e mirë për arsy se po ma nxit nostalgjinë (buzëqeshë). Mitrovica me dy lumenj të mdhaj Sitnicën edhe Ibrin, përveç që ja ka mundësu me pasë pastërtinë kulminante, ja ka mundësu që rinia, pionierët me mësu edhe notimin. Me i përjetu të gjitha ato të mirat, të cilat i dhojnë lumenjtë të cilët kalojnë nëpër Mitrovicë. Mitrovica e ka pasë *Domin* [serbisht - Shtëpia] e Kulturës, në vitet e '50-ta, '60-ta, ka pasë shoqnitë të cilat janë marrë me folklor, me muzikë, po ka pasë edhe klube të cilat kanë organizu për radiolidhje dhe foto klube. Fatbardhësisht, unë ato klube krejt në atë kohë i kom kalu edhe si foto-amater edhe si radio-amater, për arsy se në Mitrovicë krejt ato kanë qenë të organizume, në vitet domethonë '50-ta.

Anita Susuri: A kanë qenë si në kuadër të shkollës apo vet jeni angazhu?

Burhan Kavaja: Jo, në kuadër të qytetit kanë qenë. Në kuadër të qytetit kanë qenë të organizume si klube, jonë financu pjesërisht prej komunës, pjesërisht edhe pjesëmarrësit aty që kanë qenë. Ka qenë diçka që besoj si kanë përjetu qytetet tjera në atë kohë nëpër Kosovë. Jo se jo, Prizreni. Prizreni ka qenë një qytet jashtëzakonisht i mirë, i pasur, me kulturë tepër të lartë, mirëpo Mitrovica e ka pasë industrinë, ka pasë të hyra, ka pasë mundësi të zhvillon në çdo aspekt jetën kulturore-artistike.

Anita Susuri: E di që ura e Ibrit disa herë u rrënu, u ndërta, a ju kujtohet atëherë qysh ka qenë?

Burhan Kavaja: Qysh jo, qysh jo. Ura e Ibrit osht’ njo prej urave të asaj kohe, e veçantë, e metalit. E ndërta me pjesërisht me farkim, e cila ka qenë e ngushtë, po e ka pasë karakteristikën e vet që kur kalonte pajtoni krejt ura u dridhte prej inercionit të kambëve të kuajve (buzëqesh). Ajo ka qenë një

karakteristikë e veçantë që si fëmijë shkojshim në urë me nejt edhe me pa se si po lëvizë ura, si po dridhet ura. Kuptohet në urë kanë qenë vendet ku jena la si fëmijë, Gjana, ka qenë pjesa Kekiqit, mullini Kekiqit. Për mullinin e Kekiqit du me ju dhonë një histori shumë të shkurtë.

Ka qenë një mulli me vlera historike jashtëzakonisht të mdhaja, i ndërtum para Luftës edhe pas Luftës u rrënu krejt pasi që nuk e mirëmbajti kërkush. Kur isha në “Sharr” të Hanit të Elezit, ju pata propozu edhe e pata pru vendimin që me ju ndihmu me material ndërtimor prej “Sharrit” në Mitrovicë për ndërtimin e Mullinit të Kekiqit, ka qenë për neve një histori e veçantë ai mulli. Dhe nostalgjia për atë kohë kur shkojshim për Shëngjergj me shelne, e i marshum aty edhe hithat, ato janë gjanat që njëherë i përjeton njeriu edhe mo kurrë jo, veç kujt i kujtohen.

Anita Susuri: Shelne a jonë lula, lojë, çka osht’?

Burhan Kavaja: Shelne...

Anita Susuri: Dikush që nuk e dinë (qeshë)

Burhan Kavaja: A p’e sheh që... shelnat jonë... m’doket edhe shqip i thojnë qashtu {ngrit supet}. Si qato aty te {tregon mbrapa vetes me gisht} çeshmja që osht’.

Anita Susuri: Shelgjet ndoshta?

Burhan Kavaja: Shelgjet, shelgjet. Me shelgje u kuptu, shelne jo, shelgje po (qeshë).

Anita Susuri: (qeshë) Që m’u sqaru...

Burhan Kavaja: Po, po.

Anita Susuri: Mirë, deshta tash me ju pyt edhe diçka për dyqanin e babës ju, se m’u duk interesante, sigurisht e mbani mend kush ka ardh aty me qepë tesha, a kanë qenë njerëzit e rangut ma të naltë apo që kanë qenë ma të pasun, apo...?

Burhan Kavaja: Në atë kohë kryesisht tesha qepshin ata që ishin nëpër pozita, ose të punësum në Trepçe. Pas një kohe jo të gjatë, të gjithë ata u orientun që teshat t’i marrin jashtë. Për arsye se ju dokshin që baba ka met i demodum për ato teshat çfare i kanë qepë. Prandej ky ka vazhdu me zejen e vet edhe përmi 80 përqind fshatarët mandej jonë furnizu aty te baba me tesha. Ka qenë një zejtar i cili... më doket i treti në krejt Mitrovicën në atë kohë edhe ka qenë një burrë thatanak, i gjatë edhe shumë punëtor (buzëqeshë).

Insistoj une një të dille që të shkojmë te shohum lojën. Ma tepër se nuk dojsa me lonë ato vetëm në dyqan që i nimojsa po edhe kisha nevoj pak një argëtim në atë kohë. Vendosi edhe erdh me mu, shkum po e shiqojmë lojën kur disa fëmijë jevg¹ {tregon me dorë gjatësinë e fëmijëve} po e mbledhin gjithë atë savatimin që ka ra, që e kanë ndërtu stadionin, po e mbledhin me kofe edhe po e çojnë në

¹ Evgjit - pjesëtar i një grupi banorësh që jetojnë në vende të ndryshme të Ballkanit, prejardhjen e të cilëve populli e lidh me Egjiptin.

shpi. Baba i pa ata, po thotë, “Burhan, këta po kqyrin për idare [mbijetesë] e unë jom ardh këtu me kqyr top! Rri ti këtu, une shkova” (qesh). Edhe më la mu në stadion, ai iki.

Korab Krasniqi: Cila lojë ka qenë?

Burhan Kavaja: Po, në atë kohë, kishte lojë Trepçës, Rudarit, lojë... edhe Trepça ka qenë në ligën e katërt. Ka qenë një ligë e futbollit e cila në atë pjesën e Sërbisë ka nxonë vende jashtëzakonisht të rëndësishme. Pasi që ligën e kishim të përbashkët me Sërbinë, me Kralevē, e Kragujevc, dhe Beograd.

[Këtu ndërpritet intervista]

Burhan Kavaja: Muj me thonë se në atë kohë pa dallime nacionale, ka pasë argëtime të përbashkëta. Fatbardhësisht une e kom pasë shpinë ku kom punu në Mitrovicë, në qendër të qytetit te Domi [Shtëpia] Armatës së vjetër edhe në *Domin* e Armatës dy herë në javët u organizojshin kurse për vallëzim...

Korab Krasniqi: A është tani muze ky objekt?

Burhan Kavaja: S’ju kupotova?

Korab Krasniqi: *Domi* Armatës, a shfrytëzohet si muze sot, a po flasim për atë?

Burhan Kavaja: Jo, e kanë shkatërru.

Korab Krasniqi: E kanë shkatërru.

Burhan Kavaja: E kanë rrënu krejt. Në *Domin* e Armatës dy herë në javë u majshin kurse për vallëzim. Edhe aty si fëmijë na i përcjellshim ato gjana, dikur edhe vet ishim pjesëmarrës të atyre kurseve për vallëzim. Po, dy ditë tjera të javës u majshin kurse për instrumente, instrumentalista. Ata të cilët dijshin, kanë qenë vllaznit Tumbaku, kanë qenë do sërbë, të gjithë ata ushtrijshin edhe ma vonë ishin në elitën e instrumentalistave, të cilët e prezantojshin Mitrovicën si në Kosovë edhe jashtë Kosovës.

Domethonë, ka pasë një jetë kulturo-zbavitëse, për habi shumë ma të madhe sesa dikur ma vonë. Ndoshta gjendja edhe standardet që kanë qenë të ulëta të jetesës, kanë mundësu disi që të gjithë të shoqërohen edhe të jenë në njëfarë mënyre si uniformë {lëviz duart paralelisht} për përcjelljen e të gjitha atyre kurseve. Edhe siç ka qenë rasti për shembull me qytetet tjera, na kem pasë rininë e cila ka ditë me vallëzu, ka ditë m’u argëtu, e kena pasë teatrin. Domethonë, e ka pasë një jetë kulturo-artistike Mitrovica edhe në vitet ‘50-ta, ‘60-ta e cila ka qenë për shembull për viset tjera.

Anita Susuri: A keni shku ju në teatër si i ri?

Burhan Kavaja: Po, po. Jo që kom shku po kam qenë kajherë edhe pjesë e atij teatri. Kuptohet si statist (buzëqeshë), por kam qenë edhe pjesë e atij teatri. Më kujtohen shumë “Don Kishoti” e do pjesë të cilat në atë kohë u lujshin e ishin qesharake.

Anita Susuri: Si ka qenë atëherë... se po më duket që është dashtë një veshje e veçantë nëse ke shku në teatër për me pa një shfaqje ka qenë një përgaditje ma e veçantë.

Burhan Kavaja: S'e di ajo, për atë kohë mu duke për të gjithë e njëjtë, të gjithë merrshim pjesë. Nuk mendoj që ka pasë najfarë dallimi ose ndarje mes atyre ma të pasun ose ma të varfun ose ma të dijshëm ose ma të padijshëm. Për arsye se të gjithë e kishim afërsisht një arsimim të njëjtë. Ose ishum me shkollat tetëvjeçare ose i patëm fillu shkollat e mesme. Na e dijmë që edhe atëherë kur fillum si studenta në Shkollën e Naltë Teknike, patëm organizu "Mbramje të Kaltërta" edhe lloj-lloj temash tjera në Mitrovicë. Mitrovica ka qenë një qytet i gjallë. Besoni shpesh ata që vishin prej qyteteve të mëdha për me nejt te familjart e tyne, thojshin, "Po ju bre këtu e keni një jetë jashtëzakonisht të mirë". Po edhe e kishum, e kishum. Mirëpo, kur erdh periudha e punës edhe lufta për ekzistencë, u harrun të gjitha ato argëtime, ato gjanat që ishin me randësi.

Korab Krasniqi: Zoti Burhan, dashta me të kthy edhe pak mrapa nashta nuk e ki problem. Dashta me të pyt për nanën Xhevahire, qysh e man në men', çfarë gru ka qenë?

Burhan Kavaja: Fatkeqësisht e maj në mend si një gru e cila ka qenë jashtëzakonisht punëtore e madhe edhe sot më kujtohen kambët e saja me nallune², të skuquna, në borë, kur e shtrijke kazanin me hi për me na la teshat. Atëherë sapuni ishte i rrallë, për fëmijëni jom t'u fol, mandej krejt ka qenë ndryshe, ajo u dashtë neve, me na la, me na pastru, me qato teshat të cilat i kishum. Po ajo nuk kishte në atë kohë qerapa me vesh, po me nallune, me komb të skuqne nëpër oborr, e ku ishin shpesh edhe nallunet të mbulume me borë.

Domethonë ka qenë një histori e përjetimit. Mirëpo, nana Xhevahire kurrë në jetë vojnin se ka shti në gojë. Kurrë në jetë t'lynin [vajin] e bimëve se ka shti në gojë. Ka ndodh që me qenë e thirrne naj darkë ose naj darsëm, bukën e ka hongër me një spec. Për arsye se s'ka pas besim që aty nuk e kanë përdor vojnin. Ka hongër veq t'lyn kur ka pas, po ka rrnu 96 vjet. Edhe osht' për çudi baba ka rrnu 76 vjet, ajo 96 vjet. Ka ninu [agjëru] Ramazanin, po karakteristika që është për çudi për të gjithë neve ka qenë kjo që kurrë vojnin në gojë se ka shti. A po ju doket edhe juve çudi kjo punë a jo? [I drejtohet intervistuesve] (qeshë)

Anita Susuri: (qeshë) Ajo është shumë mirë, po e paarritshme për neve po më doket.

Korab Krasniqi: Na tregut për vëllezërit edhe për motrat, thatë që jeni vet i katërti vlla në familje.

Burhan Kavaja: Po.

Korab Krasniqi: Edhe dy motra, njona prej motrave...

Burhan Kavaja: Ka vdek. Shivizati ka vdek.

² Tur.: *nalin*, nanulle, një lloj i papuqeve me një taban druri dhe një rrip të vogël sipër.

Korab Krasniqi: A munesh me na tregu qysh kanë qenë dinamikat mrena për mrena vllaznive, motrave?

Burhan Kavaja: Shivizati na ka vdek 21 vjeçare, '61-shin. Kena met na katër vllazën me gjithë motrën e vogël Shukrinë, e cila tash është në pension, si msuse ka punu krejt kohën, të cilët i nimojshum nanës. Pikërisht edhe këtu po du pakës mu lidh ç'a do të thotë një harmoni në familje. Kena pasë një harmoni jashtëzakonisht të madhe, sa që kur u çojshim në mëngjes të gjithë prej neve i nimojshim nanës me i çu dyshekët. Kuptohet në dysheme dyshekët e shtrumë {lëviz dorën sikur prek dyshekët} edhe ne si sardina aty. Motrën e vogël, e kishum shumë të vogël.

Edhe po në qoftëse u dufke diçka mi nimu nanës nuk u thirrshum me emën Ramadan, Rexhep, Orhan, po njishi, dyshi, treshi, "Shko nimo nanës. Shko nimo!" (buzëqeshë) Ka qenë një harmoni jashtëzakonisht e madhe. Vëllau i dytë Orhani, tash gjindet në Londër me familje, me fëmijë, me krejt, atje ka migru para një 20 vjetësh. Vëllau i tretë Rasimi ose Ramadani edhe ai i ka dy emna, osht' këtu, osht' në pension, inzhinjer i maçinerisë. Ka dy vajza, e dy djel, thuja të gjithë të rahatun, mirë. E kanë një jetë mesatare.

Anita Susuri: Pse i ka dy emra?

Burhan Kavaja: (Buzëqeshë) Shkon baba e regjistron me emër Rasim, kur kthehet, gjyshja p'i thotë, "More Hajrullah, ti a e din që e kena Rasimin tonë Qerkagjiun. E qysh ja ke vnu emrin?" Thotë, "Ani de s'e kom ditë, që po ja lojmë Ramadan, se ka le në Ramazan" (qeshë). Edhe kështu zyrtarisht e ka gjithkunj Rasim, a na e thirrur Ramadan për arsye se e kena pas Rasim Qerkagjiun ilake [kushëri] edhe baba ka harru atëhere që e kena ilake edhe e ka... Rexhepi, inzhinjer i diplomum ka punu në Elektrana, tash është në pension, ka një djalë e dy çika, të martun, me fëmijë, me nipa. Bilem këtu në mëngjes kanë qenë ata, sot e kena hongër mëngjesin bashkë, nostalgjia atëherë kur e hajshëm me babën e nonën. Edhe motra Shukria si mësuse është pensionu. Ka qenë mësuse, domethonë të gjithë kanë qenë të arsimun prej një gjilpërë të babës.

Anita Susuri: E ju qysh keni vendos me shku në këtë drejtim, a ju ka tërhjek xehëtaria për shkak se ka qenë qyteti i minierës, a...?

Burhan Kavaja: Une prej shkollës së mesme e kom pasë shumë në qef telekomunikacionin, m'u marrë me tension të ulët. Mirëpo, "Trepça" atëherë jepte bursë, bursi ka qenë ajo që më ka detyru me shku në xehëtari, se nuk kishte mundësi materiale që m'u nda prej familjes e me pasë të ardhuna për studime, pos me bursë. Bursi, kredija ma patën mundësu edhe ajo ka qenë në njëfarë mënyre kushti me të cilën jom ballafaqu si brucosh, si student.

Pjesa e Dytë

Anita Susuri: Ishim duke fol për... qysh ka ardh deri te ajo që ju me vazhdu me drejtimin. Folët për bursën...

Burhan Kavaja: Po, ishte, ishte... për arsye se me bursë m'u mundësu arsimimi, shkollimi. Pasi e kreu fillova me punu me 1964-tën në Kishnicë, si inzhinjer i repartit, mandej si udhëheqës teknik i mjeteve sipërfaqësore dhe në fund të viteve '69-'70 Azizi [Abrashi] pat kalu në organet e administratës, kërkoi që edhe une t'i bashkangjitna. Prej viteve të '70-ta e kom udhëheq Inspektionin e Xehëtarisë të Kosovës. E para herë sipas amandamenteve kushtetuse të viti '69, u formun organet e administratës në Prishtinë për Kosovë. Mandej kam qenë kryesinspektor i inspektorateve teknike, mandej zavendës sekretar ose zavendës ministri që së bashku me Azizin kena bo përgaditjet e shumë ligjeve ekonomike, të cilat fillun m'u apliku në vitet '62.

Anita Susuri: Azizi është miku juj apo?

Burhan Kavaja: Po. Duhet qet' periudhë pakëz ma tepër me ju tregu, për arsye se ajo ka të boj me evoluimin tim ma vonë si në Trepçe edhe tjetërkah. Si zavendës-sekretar për ekonomi, në atë kohë, patëm pregaditë ligjet të cilat ishin jetike për popullin shqiptar. Ligjin për Elektro-ekonomi, Ligjin për Xehëtari, aplikimi i këtyre ligjeve do të thoshte pavarësinë e plotë të Kosovës prej Sërbisë, Neni 1. I Ligjit për Xehëtari shkrunte se, "Pasuria e Kosovës osht' shoqërore edhe i takon Kosovës". Pikërisht këto kanë qenë ato bazat të cilat edhe mu si inzhinjer i ri edhe si një prej administratorëve në atë kohë ma kanë dhënë një nxitje patriotike njerëzore, mos me thonë edhe popullore. Me Kushtetutën e '74-tës të gjitha kompetencat kalun në Kosovë. Une në atë kohë me organizimin e inspektorateve edhe organizimet tjera që i kisha ndërmorëm dhe e bajtëm dokumentacionin prej Sërbisë në Kosovë.

Si sot më kujtohet kur e patëm ngarku... na e mbikëqyrshëm dokumentacionin e minierave prej Sekretariatit për Ekonomi të Sërbisë, në kamion me e pru në Kosovë. Po më kujtohet edhe kur e kom bo ndarjen e kufin mes Sërbisë edhe Kosovës në 400 metra nën tokë në Bellobërd. I patëm ftu inspektorët e Beogradit, Serbisë që së bashku ta caktojmë kufin edhe Bellobërda osht' minierë e cila i takon Kosovës edhe Sërbisë, e ndame 400 metra nën tokë me kufi. Sa herë që shkojshin inspektorët tonë me vizitu minierën edhe me e bo mbikëqyrjen edhe kontrollën e saj shkojshin deri në kufi edhe pjesën e Kosovës e kontrollojshin, pjesën tjetër vishin inspektioni i Sërbisë e kontrollonte.

Anita Susuri: Në cilin vit u bo kjo ndarje?

Burhan Kavaja: Qysh?

Anita Susuri: Në cilin vit ka ndodh kjo?

Burhan Kavaja: '72-shin, '73-shin e në veçanti ka ndodh '74-shin kur komplet osht' aprovu Kushtetuta. Mirëpo, amandamentet e viti '69, na mundësojshin atë autoritet që me bo ndarjen komplet të pasurisë.

Korab Krasniqi: Me kon e keni bo përpilimin e ligjeve, thatë që Neni 1. që thotë që "Pasuria e Kosovës është shoqërore edhe i takon Kosovës", me kon e keni punu edhe qysh e keni përpilu, qysh jeni ndi kur është aprovu?

Burhan Kavaja: Na këtë ligj e kena bo si paraprosjekt me gjithë ata të punësumit e Sekretariatit për Ekonomi. Ishin një numër mjaft i madh i tyne të cilët punojshin. Mos harroj t'ju thom ka ndodh shpesh

herë që i kena bo kopijimin e ligjeve tjera për arsye se nuk kishim kuadra aq të forta të mëdha, po çdo herë e përgaditshim projektin edhe e çojshim në qeveri, qeveria e çojke në kuvend edhe u aprovojke në kuvend. Mirëpo, parapërgaditjet qaq të mëdha i patëm bo edhe angazhu sa njeri tash s'mundet m'i spjegu krejt ato çka u bo në atë kohë. Për arsye se ishte një entuziazëm, ishte një gjo që e para herë formulojshim e bojshim, në bazë të gjitha atyne amandamenteve që i takojke Kosovës. Librin e dytë të cilin e kom shkru, i përshkruj krejt këto rrjedhat cilat kanë qenë edhe kur ka ardh Kushtetuta e '74-tës, na i kena pa të gjitha ligjet ekonomike të aprovume edhe funksionojshin me organet e Sekretariatit për Ekonomi të Kosovës.

Anita Susuri: Deshta m'u kthy pak ma mbrapa edhe mu ndërlihdh pastaj me këtë pjesë. Te udhëtimi ju jasthtë Kosovës për studime, a ka qenë për herë të parë udhëtimi, domethonë në Beograd, diku jashtë që keni shku edhe si ju është duk juve kjo?

Burhan Kavaja: Ju kisha lut veç edhe një herë me përsërit se pak ma dobët ju ndëgjova.

Anita Susuri: Po, kërkoj falje. Kur keni udhëtu për studime në Beograd a ka qenë kjo hera parë që keni udhëtu diku jashtë edhe si, si e keni përjetu ju këtë udhëtim larg familjes, larg vendit për shembull?

Burhan Kavaja: Jo, s'ka qenë hera e parë, për arsye se na edhe si studenta të Shkollës Naltë Teknike këtu, patëm shku edhe patëm vizitu edhe Beogradin edhe tjera qytete. Por, si student, si brucosh në shkallën e dytë në fakultet, ka qenë hera e parë se atëherë u deshke që me siguru ekzistencën vet. Ka pasë qenë mirë se e pata marrë bursin edhe e kisha bile bursin një përkrahje materiale për me mujt me studiu. Sigurisht që ka pasë në atë kohë edhe disa telashe me profesora, të cilët kanë pasë ngarkesë nacionaliste. Mirëpo, shumica nuk kanë pasë asi ngarkese, shumica u sillshin në mënyrë shumë korrekte. Bilem disa prej tyne më patën jep mësim në Shkollën e Lartë Teknike këtu në Mitrovicë.

Qashtu që si student i këtuhit, nuk ka qenë lehtë. Por, do t'ju tregoj një epizodë shumë interesante. Vendosa që t'i shtyj pak studimet pas vitit të parë, arsyeja ishte vetëm materiale edhe u punësova në Shipol, si mësus. Aty ma dhanë landën e matematikës, fizikës dhe kimisë. Në shtator fillun edhe kurset për të rriturit në mbramje.

Anita Susuri: Shkolla e natës.

Burhan Kavaja: Shkolla e natës u qujt. Nji prej ditëve e kisha akustikën, zanin me spjegu si njësi mësimore. Atëherë patën dalë këto magnetofonat e "Nikolla Tesllës" së Zagrebit të ri. Edhe e morra me ju tregu si inçizohet zëri, si reprudukohet zëri. Tamam e kom lëshu me inçizu, një burrë në moshë ia filloi, "Bismilahi rrahmon e rrahim" edhe ia filloi një ilahi. S'kanë bo as dy minuta m'u çelë dera. Kuriri i shkollës kishte ndëgjju te dera {tregon mbrapa me gisht} edhe hini ma kapi magnetofonin {sikur kap me dy duar diçka} edhe e çoi. Nesrit vijne prej Sekretariatit për Punë të Brendshme te baba edhe e lojnë thirrjen që masnesra m'u lajmëru në ora 10:00 në Sekretariat të Punëve të Brendshme.

Si çdo prind {ngrit supet} edhe ai u frigu pse kjo, po më pyt mu, une s'po di çka m'i thonë. Thashë, "Për besë, kurgjo hiç". Edhe s'pi tregoj për këtë rast se si dhojsha randësi të veçantë. Nesrit shkova, më lanë me prit deri në ora 14:00 para dere, prej orës 10:00. Kur hi, më kujtohet si sot, një inspektor i

punëve të brendshme, me syza, më doket Sava e ka pasë emrin. Po më thotë, “A di pse të kena thirr?” Thashë, “Jo, s’e di”. Tha, “Kush je ti që e përhap religjionin, fenë në shkollë?” Thashë, “Une p’e përhap?” Thashë, “Une me qyrr bash une s’jom vet fetar ashtu që me përhap fenë”. Tha, “E kena të inçizume me magnetofon”. E la këtë temë edhe e kapi temën tjetër, si me u bo aktivist i tyne.

“Ti,” tha, “e ki obligim çdo javë me ardh këtu edhe me na kallxu për këtë, këtë, këtë, çka po bohet në shkollë në Shipol”. Une i thashë, “Nji gjo të tillë s’muj me bo, për arsye se ju i keni njerëzit me pagesa për atë punë, s’ka arsy që une m’u marrë me ato”. Edhe drejt me thonë pak me nifarë ashpërsie, që me pasë ditë çka kanë mujt me më bo ata, une s’isha sillë aq ashpër. Tha, “Hajt, hajt, ti. Po të thomë që nesra ki me ardhë përsëri” “Mirë”. Më lëshun mas orës tre e gjysmë, katër gati. Kur shkova po i tregoj babës. Tha, “Ti koferat edhe po shkon për Beograd menjëherë”. S’më la asnji ditë me zhvillu mësimin në Shipol, më çoi menjëherë për Beograd. Pa mundësi materiale, çka boni, qysh boni, kurrë s’më ka tregu, veç më dha pare edhe shkova. Edhe ajo ka qenë një moment jashtëzakonisht i randësishëm të karrierës sime arsimore që ma trasoi baba. Këto e kom përshkru edhe në libër edhe ka qenë një moment që... historik.

Korab Krasniqi: Çka ka ndodhë mandej në Beograd, ku keni shku?

Burhan Kavaja: Në Beograd (qesh) u mledhëm nja tre shokë që shkum prej Mitrovicës edhe shkum te “Borba”³ u takum aty, për me kërkju vend se ku do të vendosem. Nji gru trashullake na propozoi që na të shkojmë në Dushanovo me to, e ka venin e mirë e krejt. Edhe na len ma lirë pakëz se çdokund tjetër. Dushanova prej pjesës ku ishim na me fakultet ishte mjaft larg. Mirëpo, na qyrrshim ku o ma lirë. Kur kena shku, nji shpi tu u rrënu, do dyshek të zhytë, llom. Tham, “Qitu me flejt?” Atë natë qaty flejtëm i pagum asaj disa edhe u kthym. Mandej u vendosëm në Beograd të Ri, nji banesë, nji dhomë të nji banesës me qira, derisa nuk na dul *Domi* i studentëve [Konvikti].

Për *Domin* e studentëve merita ma të mëdha për regjistrimin tonë, e ka pasë Morina, qetash s’po më kujtohet emri. E Prizrenit ka qenë nënsekretare në Sekretariatit e Sërbisë, profesoresha. Ajo ka pasë jashtëzakonisht merita të mëdha, se patëm shku edhe patëm kërkju prej saj ndihmë në kuptimin e vendosjes nëpër *dome* edhe mundësisë që mos me na pengu ata. Se na i kishum do provime të dhanuna të Shkollës së Naltë, ajo na ka ndihmu shumë edhe ashtu vazhdum aty.

Korab Krasniqi: Qysh ka qenë jeta si student në Beograd?

Burhan Kavaja: Po muj me thonë se na të cilët ishim me ambicje për me kry sa ma parë edhe m’u kthy me marrë nji rrogë, kena pasë nji jetë të vështirë. S’kena mujt m’u vendos edhe m’i përcjell ata tjerët të cilët e kishin kohën shumë ma të lirë. Na ju kena pasë dhonë shumë mësim, pikërisht edhe për ata na arritëm atë që ju tregova në fillim se m’u, m’u duft mandej me shku me marrë leje të veçantë për me diplomu para afatit.

[Këtu ndërpritet intervista]

³ Ndërtesa ku është prodhuar gazeta “Borba”.

Korab Krasniqi: Edhe një herë veç po kthehem. Për demonstratat e '68-tës edhe...

Burhan Kavaja: Edhe... ma vonë për demonstratat. Ne si Kosovë nuk kena qenë të përgaditun për një avansim ma të lartë të zgjedhjeve kushtetuese. Ne mas '45-tës kena ardhë me një situatë që kena pasë në gishta intelektualë të Kosovës. Me themelimin e univeristetit në vitet '70-ta, ne fillim një prodhim, kushtimisht me qujt të kuadrit shqiptar me fakultete. Tek e tuk kishte njerëz si unë edhe tjerë që patën kry nëpër Beograd, Zagreb e Ljublanë, mirëpo ishte numri shumë i vogël. Me kuadra të cilat dolën nga Universiteti i Prishtinës, ku kom edhe une pjesëmarrje në ato kuadra, ne krijuam një kuadro të mirëfilltë që kishte mundësi m'u ballafaqësu me teknikën dhe teknologjinë, arsimin, kulturën, jurisprudencën në Kosovë.

Pikërisht, kjo na ndihmoi që ne të krijojmë asi kuadër, që në fillim të viteve '80-ta ne kishim përmi 70 përqind të kuadrit shqiptar në vende kyçe. Edhe atëherë mujshëm me bo diçka për organizimin kushtetues të Kosovës. Pa kuadra na kot kena mujt me pasë edhe republikën, edhe organizimin tjetër kushtetues kur s'ki pasë kuadra, edhe sot ne duhet çdo gjë me bo që të kena ma tepër kuadra. Një shtet i pamvarur si Kosova kërkon me qindra kuadra për diplomacion. A mos me thonë që diplomacioni varet prej prodhimit material të shtetit. Domethonë, duhet me mijëra kuadra t'i kena në prodhimin material, për krijimin e kushteve për të hyra më të mëdha, për të ardhuna më të mëdha, që t'i mundësohet superstrukturës cilësore me na mbrojt edhe me prezantu Kosovën në shtetet e jashtme.

Korab Krasniqi: Meqë po më duket që në aspektin e periudhës jemi qatë pari, ma herët fillut me fol për '74-tën kur veç kompetencat ju dhanë...

Burhan Kavaja: '74-tën.

Korab Krasniqi: Ju kanë dhanë Kosovës, sepse është ndryshu Kushtetuta në atë kohë, edhe mu më boni përshtypje një pjesë kur thatë që ju keni kërku, që të bëhet transferi i dokumentacionit të minierave prej Serbisë në Kosovë.

Burhan Kavaja: Kërku jo, po e kena marrë dokumentacionin...

Korab Krasniqi: A munesh me na spjegu pak qet' pjesë?

Burhan Kavaja: Po.

Korab Krasniqi: Ku jeni kon ju atëherë t'u punu, qysh ka, qysh ka ndodhë krejt qekjo?

Burhan Kavaja: Une prej vitit '70 kom qenë në Sekretariat për Ekonomi, aty kom qenë së pari si inspektor i xehëtarisë, mandej si kryeinspektor i Inspektorateve Teknike, mandej zëvendës ministër ose zëvendës sekretar. Në periodën kur në Beograd u votun amandamentet për të drejtat që Kosova me e pasë autonominë e vet. Atëherë, ne i fillim përgaditjet për Kushtetutën e '74-tës. Ju thashë, në '72-shin ne kena qenë të përgaditun me të gjitha ligjet. Une në atë kohë kam qenë në Sekretariat si inspektor ose kryeinspektor, ma vonë '74-tën kam qenë zëvendës sekretar për ekonomi. Në këtë periudhë neve na vyjke për përgaditjen e mirëfilltë, profesionale, dokumentacioni. Ne kërkuam që

dokumentacionin... masi ata nuk kishin kompetenca tjera këtu në Kosovë edhe mundësi që me bo mo kontrollimin e minierave në Kosovë, atëherë insistova edhe shkum e morëm në Beograd dokumentacionin, na dhanë ata po jo bash me qef ashtu. Kjo ka qenë ajo periudhë kur i morrëm të gjitha dokumentacionet prej atjehit këtu.

Korab Krasniqi: Veç edhe një pyetje mandej po ia lo Anitës. Çka keni gjet në dokumentacione diçka që ju ka ndihmu juve në punë?

Burhan Kavaja: Shumë me randësi ka qenë dokumentacioni gjeologjik, i cili kish qenë në atë kohë krejt i akumuluar në Beograd për rezervat, për resurset, për rezervat e cilësisë, cilësitë e landëve të para minerale në Kosovë. Si “Trepçës” ashtu edhe Obiliqit, ashtu të Leposaviqit, Kishnicës, Novobërdës. Ai dokumentacion na ka mundësu ma vonë që me Azizin me përgaditë një material të cilin e kena pasë në tubimin shkencor ma vonë në Tiranë, “Resurset e Kosovës si mundësi e zhvillimit ekonomik-shoqëror të Kosovës” ku e patëm dhënë vlerën e këtyrë resurseve dhe 505 miliard dollarë me çmime kur një barrel ka qenë dhetë dollarë.

Kryekëput pasuritë e Kosovës janë në kaustobiolite, në thëngjille, pjesa e landëve të para minerale, të metaleve të ngjyrosura është mjaft e konsumume. Me hulumtime të reja mundet me ndodh që rriten ato rezerva, po në përgjithësi jonë të konsumume. Po kjo ka qenë ajo që neve na jepke një shpresë se pas luftës me një organizim të mirëfilltë, me një kuadër profesional, ne shumë shpejt do ta arrijmë një shkallë të zhvillimit edhe një standard i cili kishte me qenë i lakmushëm edhe për Evropë. Fatkeqësisht kjo nuk ka ndodh, ndodhi diçka e kundërta si me shitjen e gjithë atyre aseteve. Të gjitha u krijun me mund e me gjak, u organizun në uzina, toka pjellore, vneshta, pyje, u shitën edhe nuk dihet fati tyne se çka u bo me krejt ato.

Pati Kosova një zhvillim të hovshëm edhe të mirë, pati për arsye se ne kishum mundësi të krahasimit. Ishim me një të pestën e të hyrave nacionale në vitet ‘70-ta, arrijtëm në vitet ‘80-ta me pasë një të tretën, prej një të pestës një të tretën e të hyrave nacionale *per capita* [për kokë banori] për Jugosllavi. Ishte një angazhim shumë i fortë, një prodhim shumë i madh material. S’e di, ju jeni të ri s’ju kujtohet, nuk ka pasë çka s’ka pasë prej prodhimit në Kosovë, në vitet ‘80-ta. Si prej landëve të metaleve të ngjyrosuna, ashtu prej tekstili, bujqësisë. Me dy komplekse “Agro” kompleksi “Agro Kosova”, kombinati “Trepça”, kombinati “Obiliqit” deri sa patëm bo hulumtime që prej qymyrit m’i prodhu njëqind produkte tjera.

Një prej produkteve ka qenë edhe prodhimi i margarinës e kena pasë uzinën për prodhimin e gasit, të vetmen në Evropë. Ka qenë kapaciteti 480 milion metra kub. Atë gas e ka përdor shkëritorja e Shkupit, ma vonë une masi e disha e kom përdorë në Han të Elezit. Gazsjellësi ka qenë prej Shkupit deri në “Trepçe”. Fatkeqësisht të gjitha ato tash jonë në zero.

Anita Susuri: Në cilin vit ju jeni bo drejtor i “Trepçës”, edhe qysh ka ardh deri te ajo?

Burhan Kavaja: Paraprakisht po du me ju tregu si shkova në “Sharr”. Ymer Pulaj ishte kryetar i qeverisë po më thirr, unë atëherë isha në Odën Ekonomike sekretar për zhvillimin e industrisë.

Anita Susuri: Në cilin vit, nëse bon?

Burhan Kavaja: ‘80-shin.

Anita Susuri: Po.

Burhan Kavaja: ‘80-shin. Bash viti ‘80. Po më thirr edhe po më thotë, “Ti duhet me shku në ‘Sharr’ të Hanit të Elezit”. Negociatat fillun edhe unë disi e zgjata atë punë pakëz. Kur më thirri hera dytë veç kalum në vitin ‘81-sh (buzëqeshë). Tha, “Ti do të shkojsh aty si drejtor i dhunshëm” për arsye se 4 milion dollarë ishin humbjet. Mu duft me shku, kom shku me 3 ose 4 maj. Menjëherë fillova një aktivitet po kisha rezistencë shumë të madhe prej atyre vendasve aty. Mirëpo, i përballova të gjitha ato. Në fillim të vitit ‘86 më thirrën në Komitet edhe po më thojnë, Azem Vllasi tha, “Ti do të shkosh në ‘Trepçe’”. “Sharrin” e lash me 4 milion dollarë fitim, prej 4 milion dollarë humbje.

Anita Susuri: “Sharri” çfarë kompanije është nëse mundeni me na tregu?

Burhan Kavaja: Cementara, e prodhimit të cementës, gëlqerës, azbest beton, gypave. “Sharr” o thirr. Une mendova se po e dini ju kombinatin.

Anita Susuri: Duhet me cek për dikond që s’e din.

Burhan Kavaja: Edhe e lash me një fabrikë të re të gazbetonit, “Sillkapori”. Domethonë, 4 milion dollarë fitimi, 2650 punëtorë edhe fabrikën e re të “Sillkaporit” që u ndërto. Ma vonë kom marr vesh se 18 vetë në Han të Elezit edhe në rrethinë aty ju kanë lonë emrin Burhan fëmijëve të vet (buzëqesh). Sot kur kaloj në kufi në Han të Elezit me një respekt të veçantë më përshëndësin. Tu mendu që mbas 30 vjete më kanë harru {lëviz dorën}, nuk më kanë harru. Më thirrën edhe më thanë që duhet me shku në “Trepçe”. Tha, “Kena kushtëzim prej Azizit, ai për me shku në ‘Trepçe’ ka kërku veç ti me shku atje”. Po më thirrë mu Azizi, tre muj ditë i kam ik bisedave me Azizin, nuk dojsha me shku, se më patën premtu ose në Odë të vi ose të shkoj në qeveri.

Edhe katër vjet e diçka u bo, përditë t’u udhëtu për Han të Elezit, ishte monotoni, rrezik, lodhje, Mas tre muje thirr Azem Vllasi edhe thotë sekretareshës aty, thotë, “Nesra në tetë me na ardh Burhani këtu në kuvend”. Kur shkoj aty e shoh Azizin, “Çka po bon ti Aziz këtu?” Më thotë, “Ti çka po don këtu?” (qeshë). Unë e disha që ai ka insistu për atë punë. Hijmë na pyti për kafe edhe tha, “Burhan ti duhet me lonë ‘Sharrin’ edhe duhet me kalu në ‘Trepçe’”. Thashë, “Po një marrveshje që e kom duhet me kalu në Prishtinë, tash prej një udhëtimi në një udhëtim tjetër” {lëviz dorën}. Mos me zgjat vetëm ishte punë e kryme ajo edhe une menjëherë mas pesë dite u lajmërova në “Trepçe”, Këshilli Punëtor e mbajti mbledhjen, më caktun mu drejtor në Stari Trg edhe aty ja fillova.

[Këtu ndërpritet intervista]

Burhan Kavaja: Pas pesë-gjashtë dite u caktu Këshilli i Punëtorëve në “Trepçe” edhe më emnun mu drejtor i minierës me flotacion. Tuj mendu që po kthena me Azizin së bashku, Azizi tha, “Une qetash

me ty s’du me fol mo. Ti shko rrugës tonde, une rrugës teme. Kur të thirri s’ki qare pa më ardh se për mu s’erdhe po Komiteti të çoi”. Edhe qashtu ndodhi (qesh).

Pjesa e Tretë

Anita Susuri: A mundeni pak ma shumë me na tregu për këtë Azizin kush është, me emër, me mbiemër me na e prezantu se po e përmendni disa herë po...

Burhan Kavaja: Po, patjetër. Po para asaj po ja u tregoj nja dy raste kështu pakëz që e jepin fotografinë e tij si njeri.

Anita Susuri: Po.

Burhan Kavaja: I erdh një mysafir në “Trepçe” aty, një shok i joni, edhe t’u mendu që do të na çonte në drekë në “Numër tre” që e kish hotelin e vet për reprezentacion, po i thotë atina, tha, “Blerim, hajde se Bahtia ka maru pite po shkojmë në shpi”. Njeri jashtëzakonisht kursimtar. Ose edhe një karakteristikë tjetër, po kthehem së bashku prej punës me ardh në Mitrovicë, në Prishtinë, e kishum edhe Asllan Barutin. Une, Azizi, Asllani edhe Azizi, edhe... na tre edhe shoferi. Po më pyt mu rrugës, tha, “A i ndatë rrogat?” “Po”. “Sa e more rrogën?” Edhe unë po i tregoj sa. Tha, “Eh, mirë. Nale kerrin në ‘Vicianum’”, u nalëm në “Vicianum” edhe po kqyrë atje ç’a ka ma së shtrejt, e mur hongrëm krejt edhe une po i thom Asllanit, “Shyqyr që njëherë ky kryetari jonë na çoi një drekë me na dhonë se kurrë një kafe s’ta jep”.

Kur u kry ajo po i thotë kamarierit, “Paguja Burhani, t’i jep paret”. Po i thom, “Pse?” Tha, “Me kajt nonën e nonës une kryetar i Këshillit Punëdrejtus, e ma i nalt se ti, e ti drejtor aty, e na me shku në Prishtinë, e rrogën ti ma të madhe se une, s’bon! Ki me lone ato që është tepëricë këtu”. Azizi ka qenë një student jashtëzakonisht i madh, me moshë ma i vjetër se une nonë vjet. Kena rru një rrugë të përbashkët në Mitrovicë. Pas diplomimit në Beograd me sukses të shkëlqyshëm, ai ka punu në industrinë kimike, në tregtinë e naftës edhe ma vonë ka qenë Ministër për Ekonomi, në tri mandate. Një burrë jashtëzakonisht i sinqertë, një luftarak për të drejtat nacionale, kombëtare deri në fund. Po edhe i fjalës, edhe i fjalës.

41 vjet kena qenë bashkë në kuptimin e punës, afarizmit. Shpesh kur u idhnojke diçka në mu, thojke, “Kqyre kom me shku abës m’i kallxu” {tregon me gisht djathtas}. Une njeri 60 vjeçar, ai me u anku te nona jeme (qeshë) për mu. Domethonë, ka qenë i dashun, i dashun edhe ai më detyroi me shku në “Trepçe”. Masi u burgosëm, në burg një ditë e kom pa... se shkojshim në gjykim, tu qa, tu më kërk falje, “Pse edhe ty të mora në qafë që erdhe në ‘Trepçe’”. Për te shumë, shumë fjalë të mira. Ka qenë kursimtar, nuk besoj që prej pasurisë të shtetit përveç naj drekë a darkë që ka shfrytëzu diçka. Ka qenë i një familjes mjaft, mjaft të vorfun, ka rru me vllazën edhe motër në Mitrovicë, pasi që ka ardh në Prishtinë ja ka fillu me kriju një jetë, një standard më të mirë. I ka një çikë e një djalë.

Djalit e ka tash një biznesmen të njoftun, e mban një zinxhirë lokalesh, vetëshërbimesh edhe vajzën e ka afariste Mena dhe Linda, Gazmend Abrashi i ka këto vetëshërbimet, të cilat janë “Maxi” me 12-13 a 15 qasi edhe Lindën e ka afariste të njoftun. Domethonë, i ka lonë do fëmijë të artë, të mirë. Zonja Bahti ka qenë shoqe e klasës sime, na bashkë kena qenë në shkollë, ajo ka qenë mocanike me mu edhe ajo krejt jetën e ka çu, përveç në fund të jetës, në arsim, në fund të jetës ka qenë aktiviste e organeve shoqëro-politike të Kosovës. Qishtë për Azizin, tash i mush, vitin e ardhshëm shtatë vjet që s’osht’ mo me neve.

Anita Susuri: Më tregut që ai ka qenë shkaktari që ju me ardh në “Trepçe”, e qysh ju ka dukë juve kur keni ardhë edhe gjithë atë përgjegjësi me marr?

Burhan Kavaja: Une pak “Trepçën” e kom njoft nga aspekti i kontrollit që e kom bo si inspektor. Qashtë që pas “Sharrit” ku i kisha 2650 të punësuar, “Trepça” ishte sfidë e madhe. Mirëpo, sfidë ma e madhe ishte që për herë të parë po ballafaqësohna me prodhim material të resurseve nëntokësore, une si kontroll po, po tash kur u dufke me krijë të ardhuna prej prodhimit nuk ishte lehtë. Ndoshta edhe pavarësia ekonomike, një mundësi e krijimit të një eksperience jashtëzakonisht të madhe profesionale, si në organe të administratës, në Odë Ekonomike, në prodhim edhe si ligjërues në fakultet, ma jepke një kurajë, një forcë, që besoni i ndisha si gjana shumë të lehta.

Mandej, një përkrahje të cilën e kisha pi shumicës aty ma jepke edhe një kurazhë ma të madhe. Dua t’ju tregoj disa raste për me mujt me kuptu që kajherë gjanave duhet me ju parapri. Ditën e parë që shkova në zyre, e mora detyrën, isha menu prej organit aty, kërkova me gëlqeros zyrën {tregon me dorë para vetes}. Kur erdha nesra ish gëlqeros zyria edhe i kishin pru fotele {hap duart sikur tregon madhësinë} të mdhaja, të mira, si naj kabinet i sulltanatit. Thashë, “Une kërkova me gëlqeros zyrën, jo me ma mush me fotele kështu”. Ata kishin probleme me të ardhuna personale, rrogat s’ishin dhonë, kishte problem shumë, material. Thashë, “Pritni mramjen, në mramje me m’i heq tona këto me i çu”. Ma kishin mush aty mosvet, lëkurë krejt.

“Po drejtor...” “Këtë punë s’du me diskutu, menjëherë...” Nesrit kuptohet i lash qato fotele që ishin, shumë të mira ishin, sa për me nejt me to. Kështu filloi dita e parë aty. Ditën e dytë m’u duft me bo një zgjedhje që mos me ardh shoferi me më marrë përditë prej Prishtinës këtu, prej Mitrovicës në Prishtinë, prej Prishtinës-Mitrovicës, i bike ka dy rrellacione të kota edhe e ndrrova Vujadinin, kjo ishte dita e dytë. Vujadini aty kish qenë një Al Kapone⁴, ma i madh se drejtori, nuk kish pasë ç’a s’kish bo, s’kish pasë çka s’ka bo! Une e ndrrova menjëherë, e mora një vozitës që e kom pasë në “Sharrit” që banon në Prishtinë, shkojshum me to edhe vishum me to. Ai te qet një letër katër faqe, me një ndihmë prej atyhit mrenda, ja çon Komitetit Krahinor e Komitetit të Sërbisë e, “Qe më ndrroi mu veç që jom sërb”.

Une e ndrrova nuk kom ditë që krijon atmosferë aq të mirëfilltë te punëtorët ajo punë. Ata e vlerësuan atë gjo jashtëzakonisht shumë. Une e mora për arsye ekonomike, mirëpo ajo dul puna që pat edhe njëfarë ane tjetër psikologjike. Mandej ndodhi që së bashku me gjithë Azizin me shku në restoran edhe me i provu gjellnat të cilat i hajshin ata, u ulëm me ta. Ajo krijoi përsëri një situatë pak të volitshme.

⁴ Al Kapone (1899 – 1947) ishte mafioz dhe biznesmen amerikan.

Kështu ia fillova punës që pytet aty qysh. Mirëpo, në të njejtën kohë fillun “Jogurt revolucionit”⁵ i sërbeve. Ja fillun sërbe me të madhe edhe prej atyhit, prej organizatës tonë kryesorët me shku nëpër tubime të sërbeve. Edhe me fillu ato marrëdhjetet të cilat i fillun shoviniste kundra shqiptarëve.

Anita Susuri: Në cilat vite u vërejt ma shumë qekjo, kur ka fillu?

Burhan Kavaja: ‘87-a ka qenë, domethonë mas një viti e gjys që shkova une, ka qenë një evoluim i këtyre nacionalistave sërbe shumë i madh. Në pjesën sipërfaqësore të minierës i kisha të punësum 240 vetë. Shumica e tyre, invalida të punës, po edhe një pjesë e madhe e tyre të Seretariatit për Punë të Brendshme, të nxjerr për minierë edhe të fut rrjetën e shpiunave. Përcillni vetëm qeto se kjo na vyn ma vonë. Asnjigjo nuk mujsha me bo pa u ditë në Sekretariat edhe në Komitet, menjëherë për dy minuta, tre minuta gjanat... Një ditë vjen një inspektor i Punëve të Brendshme i Sigurimit Shtetnor edhe po hin në derë {sikur kap dorezën e derës} pa m’u lajmëru fare. Kur hini tha, “Kom drejtor me ty punë pak” “Mirë”. Unë aty e kisha Ibush Januzin, drejtorin teknik timin edhe Ibushi po çohet me na lonë neve dyve. “Jo, jo” po i thotë, “ti rri këtu” {ulë dorën e majtë}. Ai po i thotë Ibushit nërsy meje, m’doket edhe në libër e kom përshkru ato.

Korab Krasniqi: (qeshë) E kom lexu dje.

Burhan Kavaja: Edhe po më thotë, “Drejtor...” jo Burhan {ngrit dorën}, jo drejtor, “Burhan” tha, “tash e tutje ti këtu nuk munesh me marrë kërkon as me lëshu kërkon prej punës pa e ditë unë” {bën grimasë sikur habitet}. Edhe ja nisi po ma man ni ders kështu, nga aspekti i Sigurimit Shtetnor, kuptohet mu s’më mbeti kurgjo tjetër, i shkreti. U çova ia çela derën i thashë, “Dil edhe mo mos me t’pa kurrë këtu” {ngrit duart}. S’pata tjetër shans, kur ai po vjen mu po më cakton se si, çka duhet une me bo ma tutje edhe ato s’e kom lonë kurrë mo me hi. Mirëpo, ai ishte i lidhun me këtë rrjetën këtu. Vendosa të gjithë ata që ishin invalidë të punës, e që u sillshin aty me i çu në shpi’, me ju dhonë rrogën, me ju dhonë edhe për ushqim kupona me qëllim që mos të krijojnë tollovi në autobuset kur po vijnë punëtorët se ata p’i nxojnë vendet aty të parat e këta po dalin prej minierës të lodhshëm po duhet n’komë me nejt. Qaty e kisha arsyetimin kryesor, e në esencë e kom pasë që m’u liru prej asaj rrjete aty {shtrin duart}.

Me Azizin bisedova se ushqimi nuk osht’ i mirë, e kishim të centralizum, “Edhe kom vendos” thashë, “që restorantin vet me marrë në pronë”, “Po qysh po ma shkatërro ti kombinatin?” “Valla,” thashë, “qet’ pjesë po ta shkatërroj po qeto duhet me marrë”. Edhe vendosa e mora në Stari Trg restorantin, komplet e ndava prej ushqimit shoqnor që ka qenë për krejt “Trepçën”. I pari e kom bo ato edhe ajo m’u gjind ma vonë që me ju zi punëtorëve edhe me ju dhonë drekë a darkë për 1300 vetë në minierë. Pasi që fillun këto trazira të sërbeve, e majtëm një tubim, në atë tubim ja fillun disa me tregu qysh në qoftë se me këto lakna kanë m’i mpshtjell komët që po i hajnë në restoran, gjysën e dimrit kanë me çu. Edhe unë e ktheva meniherë këtë pjesën politike edhe ngjarjet që po na ndodhin.

⁵ Rasti Jogurt revolucionit në Fushë Kosovë është një segment i Doktrinës së shenjtë serbe gjatë luftes speciale në Kosovë të zhvilluar në periudhen 1981-1990. Ky rast ka ndodhur me rastin e vizitës së Slllobodan Millosheviqit në Fushë Kosovë.

S'u duft shumë edhe ata kërkun mas bisedave që i patëm që me shku drejt për Prishtinë. Atëherë i thashë Liljana Gashiqi, "Këta po dojnë me shku për Prishtinë, ti duhet me ju pri". (qeshë) Ajo filloi me ju pri deri sa nuk dulën këta të sigurimit edhe e hiqën ato {sikur kap me dy duar diçka} edhe na shkum për Prishtinë, 52 kilometra në kamë.

Anita Susuri: E ajo Liljana kush ka qenë?

Burhan Kavaja: Liljana ka qenë një sërbe te na ka punu në mbushjen e baterive në akumulator, e ma vonë ka qenë sekretare e Komitetit të Minierës të Lidhjes Komuniste, Liljana Gashiqi. E Korabit i tregova më pat ra me shku për 23 nëndor mandej në Ditën e Çlirimit në kazemat ushtarake kur ato e thirrën majore. Domethonë, ka punu si nënpunëse, si elektriciste, në mbushjen e baterive, e ka qenë majore e Sigurimit Shtetnor. Kërkesat tona u ditën me ardhjen në Prishtinë...

Anita Susuri: E po më intereson qajo ditë qysh ka hecë qajo ditë, se me shku në komë prej Stari Trgut në Prishtinë osht' kogja rrugë e gjatë.

Burhan Kavaja: 52 kilometra.

Anita Susuri: Cka keni bisedu a çka...

Burhan Kavaja: 52 kilometra!

Anita Susuri: Po.

Burhan Kavaja: Ajo ka qenë mas tubimit që e patëm, kur disa ia fillunë m'u anku për rroga, disa për ushqim, disa për banesa. E krejt bisedën pasi ju tregova se çka janë t'u na bo tubimet e sërbeve se ku do të jemë ne si avangardë, si punëtorë, si minatorë. Fillunë diskutimet edhe e ndrrun kahjen edhe ajo u bo me kërkesë mandej që, "Kush jonë ata që neve kështu po na bojnë? Hajde shkojmë në Prishtinë!" Edhe prej atyhit qishte ka ndodh, edhe u nisëm. Aty e kishim edhe shqyrtimin e amandamenteve kushtetuese që dojshin m'i ndrru edhe krejt ai tubim që ia filloi për çashtje sociale, u shndërru në tubim publik, politik për çashtje nacionale. Kjo ishte ajo që nxiti e filloi edhe pikërisht kjo ka qenë një marsh protestus që nuk mahet në mend dikund në botë.

52 kilometra për çashtje politike, e jo për çashtje sociale. Që kur të vijmë te greva edhe greva ma e madhe botnore osht' bo në Stari Trg për çashtje politike, e jo sociale. Mirëpo, kjo ndodhi me 17 nëndor, pas asaj pat tubime, mledhje edhe në anë tjera që na dhojshin si përkrahje. Kjo zgjati krejt deri në fund, ose në fillim të shkurtit '89. Komiteti Krahinor me 17 shkurt pruni konkluzë se protestat edhe marshet e minatorëve janë akt armiqësor, kundra bashkimit-vëllazërimit dhe Kushtetutës Jugosllavisë. Dhe organizatorët e këtyre protestave duhet diferencu, me 17 shkurt na nuk kishum kohë ma tepër se tri ditë, se fillojke diferencimi. Me diferencim ne u izolojshum menjherë, u izolojshum menjherë. Edhe izolimi jonë do të thotë praktikisht e merrke minierën në dorë, tjerët. Pikërisht...

Anita Susuri: Diferencim... më fal po ju ndërprej, vetëm largimi nga puna apo edhe burgosja?

Burhan Kavaja: Largimi nga puna, ma së pari vijke me të përzonë prej Lidhjes Komuniste, largimi nga puna, përgjegjësia morale-penale, krejt ato shkojshin rradhë. Une e disha ç’na na pret. Edhe në biseda me një grup njerëzish po ju tregoj se qekjo po na pret edhe aty u vendos që na ta bojmë grevën. Kot osht’ që dikush thotë prej vetvetiu ka ndodh, pa e dhonë dikush iniciativën nuk mundet kurrë asnjigjo me ndodh. Edhe kryekëput qata që ishin në burg ishin organizatorët kryesor. Azem Vllasi ka qenë me neve në burg, ai ka qenë prej Komitetit Krahinor i burgosun. Aziz Abrashi ka qenë si përgjegjës për kombinat, unë edhe këta tjerët kena qenë të Stari Trgut. Me fillimin e grevës çdo herë edhe tash edhe ma herët kom thonë që nuk duhet me pasë bajraktar, s’kom dashtë as une as tjerët me i bo bajraktar. Për arsye se bajraktarizmi neve edhe na ka shkatërru si popull edhe prej atij momentin ka qenë, “Të gjithë jena organizatorë”. A në esencë, organizatorët ma të mirë edhe ma funksional, edhe ma... kanë qenë qata të burgosunit.

Une ju pata thonë, fatkeqësisht unë s’kom prova, por i vetmi prej drejtorëve që i kom pasë aty që nuk o burgos osht’ Beqir Maliqi. Beqir Maliqi ka qenë drejtor aty te une edhe tri-katër ditët e fundit osht’ paraqit në gjendje psiqike të randë edhe na u ka nda neve. Ndamja e tij m’ka kriju dyshime se ka qenë praktikisht i lidhun me pjesën tjetër. Prova s’kisha {vendos dorën në zemër}, po vet fakti që ato s’e burgosën rrjedh dyshimi që në njëfarë mënyre ai ka qenë i zonun me tjerë edhe na ka tradhëtu.

Se ku i gjeti të gjithë ata të cilët kanë qenë organizatorë ma me zë, të arsyshëm që dishin me spjegu pse jena në grevë, qysh jena në grevë. Osht’ Veli Osmani, i ndjeri ka vdekë, ka qenë një minator, kryepunëtorë *par excellence* [i shkëlqyeshëm]. Mursel Haziri ka qenë punëtor, kryepunëtor, minator *par excellence*. Edhe gjithë këta tjerët 14, mos t’i përmendi, me Avdi Ukë e me krejt, gjithë kanë qenë njerëz të cilët kanë ditë, kanë mujt, kanë pasë oratori edhe i kanë majt gjallë gjithë ata 1300 vetë tetë ditë.

Greva minatorëve në histori osht’ e vetmja grevë, tetë ditë për çashtje politike e jo sociale. Kena pasë edhe aty na mrena kur ia fillunë. Jo lyshin banesa, jo rroga, jo ndërrim vendimesh jo... po kur ju tregojshum që këta kanë ardh me na ndrru neve kushtetutën. Kanë ardh me na pensionu gjithë arsimtarët të cilët i kena pasë. Pedagogë prej tyne që kena mësu, e ata me i burgos tash edhe kanë ardh me çashtje tjera politike, janë aty të numërume krejt {lëviz dorën vertikalisht}, ata e miratojshin këtë edhe çdo herë me një përgjegjësi ma të madhen u bindshin se ka nevoj për një rezistencë asi çfare ka qenë ajo.

Pjesa e Katërt

Korab Krasniqi: A kishe mujt me na spjegu ditë për ditë, ja nisim pi të 19-tit, ndërrimi i tretë të cilin e zike sabahi mandej, deri me të 28-tin, qysh, çka ka ndodh mrena zgafellës? Qysh osht’ manifestu...

Anita Susuri: Qysh e keni përjetu ju?

Korab Krasniqi: Qysh e keni përjetu ju, qysh e keni, qysh me thonë, qysh osht' organizu komplet greva gjatë këtyre ditëve?

Burhan Kavaja: Po, patjetër.

Korab Krasniqi: Më fal po të ndërpres edhe një herë. Ti the që ka pasë tubime përpara edhe janë diskutu aspekte të ndryshme, po kur është vendos mandej do të thotë teknikisht po i bjen që me të 19-tin, ndërrimi i tretë... me të 20-tin ka fillu greva edhe osht' vazhdu deri me të 28-tin. Çdo detaj që të kujtohet që kishë dashtë me nda me neve për mënyrën se çka ka ndodh aty, ish konë, ish konë shumë e mirëseardhun.

Burhan Kavaja: Pjesa psikologjike e gjithë atyne protestave, marsheve, tubimeve të "Jogurt revolucionit" ndikun në prodhim. Mirëpo, me fillimin e ndërrimit të tretë edhe të parit të tubimit në minierë kur fillun grevën një pjesë e jona nuk ishim aty, ishëm larg minierës, u lajmërum edhe erdhëm në minierë. Po bisedojmë me ta edhe një pjesë prej tyne ja fillun m'u anku në çashtje sociale, domethonë ditën e parë në minierë në horizontin e dhetë. Mes grevistëve kishte edhe serbë, pasi ju spjegova une që, "Unë e kom për obligim me i marrë kërkesat e juve edhe me i parqit lartë që m'u plotësu" ata fillun edhe po i tregojnë kërkesat e tyne.

Mirëpo, kërkesat në njëfarë mënyre ashtu qysh i kërkojshin i shkrum e ia dhashë Riza Muslisë që me dalë me i shtyp, po paraprakisht ju lexova une {vendos duart para fytyrës sikur lexon} që, "A jonë qeto kërkesat e juve?" Une i pata mbledhë kërkesat edhe para asaj ngjarje që u nalën ata edhe njëfarë mënyre e disha çfare janë kërkesat tona të përbashkëta edhe po ju thom, "A jonë qeto kërkesat e juve? {numëron në gishta} Mos me ndrru kushtetutën, mos m'i lonë mi..."

Anita Susuri: Pensionu.

Burhan Kavaja: ...përzon prej arsimit mësimdhanësit, organizatorë jena krejt. A jonë qeto kërkesat e juve?" Ata, "Po qeto jonë kërkesat!" Edhe atëhere e kisha lehtë se kërkesat e tyne i mora edhe i qita, i shtypa edhe i caktova dy vetë, të cilët kanë me komuniku me masmedia.

Anita Susuri: E për grevistat serbë që thatë në fillim, a nuk e kanë ditë cilat janë kërkesat apo ju kanë përkrahë?

Burhan Kavaja: Ata kanë ardhë me kërkesa sociale edhe kur e kanë pa se une ato sociale i shndërrova në këto kërkesa të vërteta që kanë qenë të nevojshme, atëhere ata e lëshun minierën dulën jashtë, këta tjerët metën aty.

Korab Krasniqi: Kush ishin njerëzit që i takove për me komuniku me mediat?

Burhan Kavaja: Mensur Fejzën edhe Nedelkoviçin, këta dy i caktova që me komuniku me masmedia, ndërsa drejt për së drejti në minierë Veli Osmanin edhe Mursel Hazirin. Greva filloi, minatorët ja fillun me ardh të ndërrimit të parë, të ndërrimit të dytë edhe gjithë mu mledh, dikun rreth 1300 minatorë. Une kisha mundësi që m'i nal 20-30 edhe mos me lëshu tjetër kërkon. Po nuk mujsha dëshirën e tyne të flaktë për patrotizëm me ju nal se bisha si uzurpator, diktator edhe i lëshojsha në minierë, u caktun

edhe roja e cila rrin para pusit edhe i lëshon njerëzit. Aty u caktun dy Jahira, të dytë Jahir e kanë emrin, njeni Neziri, tjetri momentalisht s'po më kujtohet. Të cilët kishin për detyrë me bo seleksionimin kon me lëshu në minierë, kon mos me lëshu në minierë se në minierë mujshin me hi, me depërtu edhe tjerët.

Në atë moment kur ka fillu greva na i kena pas 2500 kilogram eksploziv në minierë, që ka mujt me qenë tragjedi shumë e madhe. Mirëpo, me një kisha thonë mënyrë shumë pedagogjike njerëzore çdo gja në minierë prej ditës parë e kena bo me marrëveshje. Filloi dita e dytë. Kisha mundësi të organizimit të ushqimit pa dalë jashtë hiç. Minatorët kanë pasë ushqim tri racione gjatë ditës, pa pasë ndikim në shëndetin e tyre, përveç kur u mbajt greva e urisë. Për grevën e urisë ajo ka qenë tjetër, kanë pasë, edhe fare nalt s'osht ditë që ka ushqim. Restoranin e bartëm në pjesën e minierës edhe çdo gjo u zi. Kishim rezervat, kishim çdo gjo.

Dita e dytë mori përmasa shumë të madhe për masmedie, fillun me arritë prej gjithkahit televizionet, radiot, gazetatat edhe atëhere na vendosëm që në minierë t'i lëshojmë veç këta të Kosovës e për ata tjerët të mahet konferenca për shtyp. Edhe qashtu vendosëm. Deri sa nuk erdhëm në situatë që prej organeve federative na vijnë ministrat dhe të na propozojnë që minatorëve t'iu jepim sedativa, që t'i mpijmë që të mos jenë në gjendje me rezonë edhe t'i nxjerrim jashtë. Kuptohet që një gja të tillë as s'e kisha leju, as s'e kom leju fare. Domethonë, edhe asi propozimi ka pasë.

Kërkojshin [Sllobodan] Millosheviqin, erdh Stipe Shuvari⁶ datën e katër ose pesë, ditën e katër ose pesë. Këtu pata një përplasje me Azizin, une nuk dojsa me e lëshu në minierë, Azizi dojke me e lëshu në minierë edhe në njëfarë mënyre arriti edhe e lëshum në minierë. Në minierë e keni të inçizume krejt ç'a ka thonë, qysh ka thonë. Edhe unë kom qenë kundër drejt me thonë, s'e di a ka qenë ma mirë a jo. Unë i ndëgjojsha minatorët se minatorët thojshin, "S'dojmë me i pa asnjë këta, veç dojmë Millosheviqin" edhe unë i ndëgjojsha s'kisha qare pa i ndigju.

Edhe Azizi insistoi edhe i thirri në minierë, dul prej minierës i dëshprum, ato e frigun se kanë me të mytë në minierë, ai fare nuk ka pasë kurrfarë rreziku. Ka qenë një organizim i mirë, i qetë, me trimëri jashtëzakonisht të madhe. Shpesh me një oratori Avdi Uka ditke me nxitë çashtjet, herë thojke, "Dhetë fmi i kom, tonë me dekë unë prej këtuhi nuk dal". Herë thojke, "Kom m'u gjujt në minierë me mytë veten" edhe e krijojke një gjendje pak ma të acarume.

Mirëpo, ajo që nuk dihet për opinion osht' se Pajtimi i Gjaqeve filloi në minierë. Pikërisht aty filloi pajtimi i gjaqeve me kërkesë që, "Ju jashtë pajtoni, ne do të jena sakrifica e juve këtu". Kishte raste kur nuk mujsha me mrri me i vizitu të gjithë, se 200 killometra janë koridoret, që çojshin fjalë, "Drejtor nuk na ki vizitu, ne jena të dëshprum shumë, jena në gjendje shumë të fshtirë". Mandej, "Ju lutem, vizitona edhe neve". Ajo ka qenë njëra prej kërkesave ma të mëdha të tyre kur ishin të shpërndamë nëpër horizonte {lëviz dorën sikur ndan diçka}.

Anita Susuri: E ju ku keni qëndru gjatë qasaj kohe?

⁶ Stipe Šuvar (1936 - 2004), politikan kroat dhe jugosllav. Në periudhën nga 30 qershori 1988 deri më 17 maj 1989, ai ishte President i Kryesisë së Komitetit Qendror të Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë.

Burhan Kavaja: Në lëvizje krejt kohën, në lëvizje krejt kohën, krejt kohën. Ky Shefqet Voca për shembull në horizontin e pestë kërkon që me shku me vizitu. Prej horizontit dhetë deri në horizontin pesë, përveç që u dufke naltësi edhe kilometra, u dufke edhe kohë. Mirëpo, çdo gja ka qenë nën kontroll, pavarësisht asaj na kena arritë në fund që pa pasë asnjë viktimë, asnjë lëndim. Shumë netë dyshemeja ka qenë guri i thatë, kurse teshat me njersa tyne mbuloj për ta. Ka pasë edhe situata ku kanë mujt me dalë kapak prej minierës me marrë ajër pak ma të pastër.

Po brengosja ime ma e madhe ka qenë dalja e dytë. E kena pasë pusin e veriut, i cili ka qenë plot me acar edhe ka qenë praktikisht i pamundshëm me kalu nëpër te. Ate m’u duft me rregullu me një numër të minatorëve që ratsësisht në qoftë se na ndodh që me pasë pusin kryesor të shembun ose në mos mundësi me dalë me pasë rezervën ka me dalë. Domethonë, për mu si njeri, si ekspert, si udhëheqës ka qenë një gjendje jashtëzakonisht e randë psikologjike se e kisha barrën e gjithë atyne. Ka pasë që edhe më kritikojshin, ka pasë edhe që nuk u pajtojshin, po në esencë shumica e tyne jonë pajtu me këtë veprim çfarë është bo.

Korab Krasniqi: Kërkesat a janë artikulu të gjitha menjëherë apo janë ardhë me kalimin e ditëve, janë artikulu edhe kërkesa tjera? Qysh a qenë qekjo a të kujtohet?

Burhan Kavaja: Kërkesat komplet qato nontë e dheta është për Kombe të Bashkume, kanë qenë të artikulume menjherë ditën e parë.

Korab Krasniqi: Ditën e parë.

Burhan Kavaja: Po. Për arsye se pikërisht ajo ka qenë esenca e asaj, esenca e asaj e këto konkluzat e Komitetit Krahinor se protestat janë armiqësore na aty fare nuk ju zbulum, nuk ju thamë. Se na... edhe protesta edhe këtu fillum për qato çashtjet parimore kushtetuese. Evoluim ka qenë Kombet e Bashkume me i njoftu, ajo ka qenë kërkesa më doket e dhetë mos gabofsha, ajo ka qenë evoluim i atyre tubimeve. Përndryshe, u çojke thojke, “Kërkoj që me m’u ndërru vendimi i punës e krejt”. A na {sikur shkruan në dorë} i kishum të formulume kërkesat edhe ju thojshim, “Mirë, a po pajtohesh me qeto?” “Po, pajtohna”. Domethonë, çdo gja ka qenë simbas arsimimit, shkollimit, mundësive, pjekurisë politike e artikulume.

Korab Krasniqi: A ka pasë kërkesë që s’është, s’është artikulu s’o publiku, të cilën e dini ju ndërmjet...?

Burhan Kavaja: Po, ka pasë. Ka qenë një kërkesë “E dojmë Kosovën Republikë”. Edhe dikush e tha ato krejt, une nuk e lash ato me dalë si kërkesë, ia spjegova atina, “Majtja e Kosovës në kësi niveli të pamvarësisë, si njësi federale na mundëson ato në shkallën e dytë. Me këto po i kërkojmë vetes mundësi të burgosjes të përnjihershme”. Mirëpo, na e dishum atë pune që kjo... kjo ka qenë kërkesa e cila... asnjë kërkesë s’ka mujt, pa kalu nëpër filtra, me u bo. Krejt... por kanë qenë të ndëgjushëm. Për shembull, është interesante dita e tetë, me lbush Januzin edhe një ekip që më përcjellshin shkum m’i vizitu punishtet, ja fillun me dalë, me i nxjerr krejt. Po ata ishin mledh krejt para pusit aty në koridor

edhe njo s'livritke edhe po vijnë po më thojnë, “Drejtor, po të thirrri ty. ‘Pa dal ti i pari, na nuk dalum asnjo’”.

Nuk ishte çashtje e frigës, po une pata punu krejt ajo që në nji farë mënyre me qenë e përbashkët, qetash mos dalë une si lider aty. Thashë, “Une kom punë të madhe me kqyrë të gjitha punishtet mos po mbetet ndonji minator në to”. Kumeditë, u shku me flejt, e ka marrë gjumi, i ka ra të fikët edhe nuk pranova me dalë i pari. Ja fillunë ata mjekët menjëherë i rrethun {vendos duart afër syve} me fasha që mos me dalë menjëherë në dritë prej tetë netëve që ishin aty. E kështu filloi dalja e tyne. Nesrit më erdhën, inspekcioni ma prunën vendimin, e mbyllën minierën. Masnesrit dul Millosheviqi në Beograd tha, “*Uhapsicemo sve, Azem Vlasija, Aziz Abrašija, Burhan Kavaju*” [Do t'i burgosim të gjithë, Azem Vllasin, Aziz Abrashin, Burhan Kavajën] e të tjerë edhe erdhën na murrën.

Anita Susuri: Po paraprakisht erdh vendimi i dorëheqjes, qysh e pritët qato?

Burhan Kavaja: Vendimi për mbylljen e minierës e pruni Millosh Janiqi, Millosh Janiqi kishte punu te une si inspektor edhe atij i vike keq. Po vjen edhe po më thotë, “Të kom pregadit vendimin kom urdhnin s'muj pa e bo me ta dorëzu që miniera mbyllet”. Atij i vike keq se ishte punëtor i imi, me mu kish punu. Thashë, “Në qoftëse e ki urdhnin” thashë, “vepro”. Edhe e mora e nënshkruva vendimin që u mbyll miniera edhe ata menjëherë e qitën policinë e rrethun minierën edhe mo nuk lejun aty me hi kërkend.

Gjatë grevave, ka këtu tetë ditë e tetë netë me fol për të gjitha veprimtaritë që janë bo në atë kohë. Por esenca e gjithë asaj ka qenë që publikisht me dalë edhe m'u pendu për këtë punë, esenca. Ato e kërkoyke Millosheviqi prej këtyne, mirëpo kërkush nji gjo të tillë nuk guxoyke me bo. Derisa në burg Ibush Januzitit i kom thonë... Ibush Januzi osht' drejtor teknik që ka qenë me mu, i kom thonë, “Maje qafën nalt edhe mos m'u mrrol kështu ose mos m'u gërbav” “O drejtor” thojke, “s'po ma manë qafa” (qeshë).

Domethonë, kom insistu që me qenë dinjitoz secili a jo m'u pendu. E tash, kur dalin disa edhe paraqiten si organizatorë, si sindikalista, si ato... po të kap muni, se ata në atë kohë kërkund s'kanë qenë, me pasë qenë i kisha përfshi në libër.

Anita Susuri: Deshta tash me u kthy, tash pak te ma personalja, te ju kur e keni kuptu që ka me ndodh burgosja edhe qysh e keni prit ju këto? Faktikisht, e keni prit po...

Burhan Kavaja: U kthym na qat' ditë që e mur vendimin se mbyllet “Trepça”, me gjithë Azizin në shpi. Edhe Azizi po më thotë, “Burhan, veshi çerapat e trasha” (qeshë). Une s'kom ditë, shpija jeme kish qenë për tetë ditë, banesa aty, e rrethume me policinë sekrete.

Anita Susuri: E mbikqyrun.

Burhan Kavaja: Po. Bilem nji detaj kështu, pas atyre protestave që u mbajtën erdh kinse gazetar i “Sindikalistit” të Beogradit te une në zyre. E lëshoi sekretari edhe ma kërkun nji fotografi. S'e kishin pasë fotografinë teme edhe tha, “Jena t'u pregadit nji monografi për ndërmarrjet të cilat e kanë marrë

dhuratën e ANVOJ-it, AVNOJ⁷-it” tha. Thashë, “Po une s’jom kon këtu kur e ka marrë Trepça e duhet drejtorin me kërkim” “Jo” tha, “jena të interesum fotografinë tone, të drejtorit tash”. Edhe unë ja u dhashë, pak e disha po jo krejt. Kur erdhën me më burgos, erdh qai gazetari me fotografi (qesh). Ai ish konë i pjesës të Leskovcit a dikun tjetër.

Qashtu që natën më kanë marrë rreth orës dhetë pa lonë mundësi m’u vesh qysh duhet. Më kanë dërgu në Sekretariat të Punëve të Brendshme të Prishtinës, pi atyhit për Mitrovicë, gjithë natën më kanë majt qutë. Nesrit gjithë ditën më kanë majt qutë. Kuptohet nuk pyetshin veç që s’më lojshin me flejt edhe qaty rishin. Aty më ra m’i pa të gjithë ata që në njëfarë mënyre i kom pa e s’kom ditë që kanë punu në policinë sekrete. Në mramje, “Në emën të popullit je i burgosun” m’i vnun... ishte një situatë s’e di a keni ndi, a ju ka kallxu dikush. Po u mbledhshin {ngrit duart} gjashtë, shtatë policë edhe përnjherë të gjithë po bërtitshin “Je i burgosun!” Krejt, edhe po të rrethojnë edhe po t’i vnojnë {prekë duart}...

Korab Krasniqi: Prangat.

Burhan Kavaja: Prangat, edhe më çunë në burg. Kur po e shoh në burg aty Azem Vllasin e kishin burgos, Aziz Abrashin, une isha i treti edhe me rradhë qishtu.

Anita Susuri: E qat’ natë kur kanë ardhë, në banesë te ju kanë ardhë a po?

Burhan Kavaja: Atë natë kanë ardh në banesë te une. Unë isha...

Anita Susuri: Familjarët a janë frigu?

Burhan Kavaja: Unë isha vetëm.

Anita Susuri: Aha, vetëm.

Burhan Kavaja: Isha vetëm fikall. Grunë e kisha në Banjë të Pejës në shërim, diskordansia, ajo ka qenë e palëvizshme edhe fëmijtë ishin te vllaznitë, unë isha vetëm edhe trokitën në derë, po krejt i rrethum nën mbikëqyrje. E hapa derën. Menjherë më urdhnun që mos me lëvizë, me marrë veç diçka shumë të vogël për me vesh. “E kena një bisedë me ty” edhe qishtu ka qenë ajo burgosja ime. Mas asaj kanë ardhë, kanë kontrollu në shpi’, s’kanë lonë gjo pa kontrollu. Edhe neve në burg, në vetmi dy muj e diçka, në vetmi. Për burg muj me ju tregu nja dy gjana që janë pak interesante. Gjëja e parë, po vijnë dy gardianë edhe po më thojnë, “Veç ti munesh Burhan me na pshtu, mos m’u korit dej në fund se mas ndrrimit tim vijnë ndërrimi me sërbe edhe Azem Vllasi osht’ tuj qajt qe dymdhetë orë”. Tha, “Ti me shku me qetësu. Me bo vaki” tha, “m’u marrë vesh na hijmë në vend teje këtu”. Edhe nime qashtu u konë.

Më çunë në vetmi të Azem Vllasit, ia fillova me Azem Vllasin me bisedu. Ai kish pasë emocione shumë se e kish pasë datëlindjen e djalit edhe ish konë në asi gjendje që s’kish mujt veten me e nalë. Kur i

⁷ Këshilli Antifashist i Çlirimit të Popullit të Jugosllavisë - ishte organizata ombrellë politike për këshillat nacionalçlirimtarë të rezistencës Jugosllave kundër okupimit të Boshtit gjatë Luftës së Dytë Botërore.

tregova që... edhe me insistimin e gardianëve edhe që krejt populli jashtë i ka sytë në ne e ne me u tregu kaq të ultë si lbushit {tregon mbrapa} ashtu qysh i thashë, atëhere arrita me e qetësu. U qetësu. Më premtoi se ka me qenë i qetë edhe në njëfarë mënyre u kry qajo punë. Njëjtën gja e kena pasë me Ukën, Avdi Ukën, kurse me Azizin ka qenë pakëz situata ma ndryshe. Ka qenë me shëndet i ligë, simbas asaj qysh e tha në burg afër një mijë hapa që i ka pi, për atë kohë krejt. E kur vike advokati Bajram Kelmendi në vizita, i kisha dy herë ka 15 minuta për mu edhe për ate. Mu veç ma jepke naj porosi të vogël edhe më thojke, “Shko se m’duhet me Azizin ma shumë me nejt” (qeshë). Edhe qishtu ka ndodh. Po në ato rrethana ka pasë edhe skena qesharake. Nji ditë na çunë të lidhun në gjykatë...

[Këtu ndërpritet intervista]

Burhan Kavaja: Azemit [Vllasi] p’i thom une, thashë, “A i ndigjove lajmet prom?” Tha, “Po bre, i ndigjova”. Kcej Azizi, po pyt, “Ku keni ndigju lajme?” Thamë, “Na e kena ka ni tranzistor, na kanë dhonë”. Azemi tha, “Po veç diçka s’u nijke bash mirë i jemi, s’e di pse ashtu”. Ky Azizi u kyç meniherë, “Qysh tranzistor ju? P’i kahit ju tranzistor?” Na hajgare bomë, a ai e kish pasë marrë ato përnime. Ose i patëm thonë njëherë që, “Të kena pa ty prej asaj vrimë aty {bashkon gishtin tregues dhe gishtin e madh} t’u shetit” “Cilës vrimë?” Na p’i thojmë, “Në derë, vrimës” edhe ai shkon i shkreti, thojtë {sikur grryen diçka me gishta} i rrjep t’u e gjetë mos ia kanë mbyllë atë vrimë dikun. Edhe qishtu ka qenë, mirëpo, nji tragjikomedi. Kjo është...

Anita Susuri: A keni pasë vizita prej familjes?

Burhan Kavaja: Po, po, kom pasë. Kom pasë vizita të prindëve mes grillave. Më kujtohet i shkreti baba pat ardhë, nuk mujke m’u përmbajt pi vajit. E shtrengojke gishtin me dhomë {afion gishtin te goja} që mos me mujt me qajt para meje. Ose rasti tjetër që u pata pregaditë e pritsha nanën nesra në vizitë, u pata pregaditë gjithë natën sesi me qëndru para saj që mos me pa ajo ndonjifarë me thonë emocione të mia. Po si erdh ajo po më thotë, “Une po mburrna me ty more Burhan” në vend që unë asaj kureshtje mi dhonë, me ja dhonë njëfarë...

Anita Susuri: Kurajo.

Burhan Kavaja: Mundësie që me qenë ma e fortë ajo ja filloj mu. Nana ka qenë jahstëzakonisht burrneshë e madhe edhe aty na lanë nja dhetë minuta me qëndru. Fëmitë m’i kanë leju m’i pa pa grilla niherë, po nji distancë, {me duar përshkruan} nji zyre, nji distancë si tash që e kena distancën. I kom pa kishin qenë të përgaditun psikikisht për me u majt, mu përmbajt edhe qashtu ka ndodh.

Anita Susuri: Çfarë moshe kanë qenë atëherë fëmitë e ju?

Burhan Kavaja: Po, Erzeni ka qenë dikun 20 vjeçar - 21 vjeçar, kurse... 19 vjeçar, kurse Floreni 17 vjeçar. Është historat, histori shumë, shumë e dhimbshme, pikëlluse, por edhe m’u mburr njeriu. Kom prit që mas të gjitha këtyre gjanave do të vijmë nji situatë, kur ka mundësi njeriu me e rrnu nji jetë të qetë, materialisht të mirë, pa probleme edhe t’u ndigju që ka përparim të dukshëm në gjithë popullatën shqiptare, s’e kom prit këtë kështu. Kom prit që mos kurgjo tjetër bile me pasë mirënjohje të cilat ju kanë shpërnda macës e *kucës* [serbisht - qenush], për neve nji gjo të tillë s’kanë dashtë me

bo. Por, përkundrazi çdo herë që është përmend rezistenca e minatorëve kanë dashtë në njëfarë mënyre me ç'bë, me minimizu, mos m'i dhonë tretman të duhun. Në rrjedha politike nuk kom dashtë me u kyç. Por, karrierën time e kom mbyll me qato rezistenca atëhere që jonë bo, mandej jom konë i kyçun në sindikatë.

Pjesa e Pestë

Anita Susuri: Po ishim, ishit t'u na tregu për burgosjen edhe për kohën sa keni qëndru aty, ju thatë që keni qenë 14 muaj.

Burhan Kavaja: Po.

Anita Susuri: Masi jeni liru... qysh ka ardh deri te lirimi edhe qysh jeni kthy në përditshmëri?

Burhan Kavaja: Unë kam qenë i bindun se lirimi nuk ka me ardh shpejtë. Mirëpo, në seancën gjyqësore me 24 prill [1990], Ismet Emra, kryetari i trupit gjykus, po thotë, "Të paditurit lirohen nga burgu sepse kanë qenë të ngarkum me aktakuzë..." edhe po ia nis po e lexon aktakuzën. Azizi nuk e ndëgjoi këtë pjesën e parë tha, "Na paskan fikë bre Burhan" thashë, "Jo, jo po lirohem" "Jo more" tha, "ndëgjo ç'a po thotë". Ai e lexojke, aktakuza ishte shumë e gjatë. Si e dëgjun këtë pjesën e parë të dispozitivit të vendimit, të aktgjykimit, menjherë dulën gazetarët edhe e publikun atë. Juve s'ju kujtohet jeni të ri, ka qenë festë në tërë Kosovën.

Në Mitrovicë janë mledhë përmi 200 mijë vetë, ka qenë dy ditë para Bajramit. Njerëzit e kanë prish ngjimin [agjërimin] edhe ka qenë kjo një datë historike 24 prilli kur osht' prish Ramazani, osht' festu, osht' bo darsëm populllore. Kena pasë me dhjeta mijëra njerëz që kanë ardhë me na uru lirimin. Bile-bile kajherë po më vjen keq edhe me përmend, po prej shtrëngimit të dorës {zgjat dorën} të cilën minatorët edhe tjerët na shtrengojshin kom pasë dhimbje tre-katër muj ma vonë. Seriozisht. Ajo ka qenë një çashtje që njeriu prej një dashnie, hareje, dashurie po ta bon edhe s'e kena ni në atë moment dhimbjet, unë tek ma vonë i kom pasë ni ato dhimbjet.

Mirëpo, lirimi prej burgut obligoi në atë kohë që m'u marrë me diçka që me kriju përsëri rezistencë se na kishin okupu komplet. Edhe, edhe Azizi edhe une shkum me ndëgju një kuvend të sindikatës të cilin e udhëheqke Hajrullah Gorani në medrese. Edhe na si ndigjus edhe të interesum se çka po punon sindikata, filloi njëfarë replike aty, qaq e madhe sa që faktikisht na dëshproi. Mirëpo, u çu Azizi edhe kërkoi unitet. Kur ata kërkun që mu kyç edhe une edhe Azizi në sindikatën e Kosovës edhe na u kyçëm në sindikatë edhe aty e fillum rezistencën, mandej sindikale për të gjithë ata punëtorë që i kishin qit prej punës. Edhe patëm bo ankesën në ILO [International Labor Organization], Organizatën Ndërkombëtare të Punës për 25 mijë punëtorë që i kishin detyru me i lëshu vendet e punës. Për shembull që një detyrim çfare ka qenë, vjen një inxhinjer i teknologjisë të ushqimit që punojke në pjesën e agro-kompleksit të mishit.

[Këtu ndërpritet intervista]

Burhan Kavaja: Edhe na u kyçëm mandej, po që kesh t'u tregu për inzhinjerin e teknologjisë e kishin qit' sërëbët me pastru zorrë. Edhe ka ardhë te na në sindikatë me na tregu edhe me pyt mendimin tonë çka me bo. Na i thamë, "Ty të vjen shumë keq që të kanë degradu kaq shumë, po me na ndëgju neve nuk e lëshon punën". Qashtu kena pasë veprime me gardianë, po ata nuk nxerrshin mënyrë se si me i degradu. Ka ndodh ma tepër se një mijë herë që ju kanë lëshu vërtetime, "A pranon ti Sërbinë?" {bën sikur shkruan në dorë} Provokim në vend të punës. Edhe këta kanë thonë, "Jo, s'e pranoj Sërbinë". Edhe i kanë qit' prej punës.

Domethonë, erdhëm me në situatë m'u ballafaqu me disa çashtje që ishin jashtëzakonisht tendencioze, nacionaliste, shoviniste, të pamoralshme, kështu që vetëm për me i qit' prej punës. Na ka ndodh rasti sa ishim në sindikatë që me shku me kërkim inkasimin e tatimit. Prej Zagrebit qeveria e përkohshme thojke, "S'duhet me punu... me pagu kurgjo prej Sërbië". A në anën tjetër, ata për mospagimin e tatimit edhe inkasimin e tatimit ju mershin pronën, i burgosshin. Edhe na ju thojshim që, "Paguni tatimin në kushte çfare jonë të inflacionit, juve ju bjen ma pak, mos me rreziku pronën edhe burgosjen".

Ose ka qenë çashtja për shembull e banesave, fillunë m'i shitë banesat komplet shoqnore, të cilat me inflacion arrishin çmimin 200-300 marka, e vlerën e kishin 30-40 mijë banka. E sërëbët i blejshin e këta tonët s'dojshin me i ble me qato pare për arsye se po ju jepin paret sërëbëve. Na patëm dalë me komunikatë që, "Banesat kur t'ju ofrohen bleni se ato s'janë të destinume me vendim të sërëbëve për juve, po sërëbëve po ju mundësojnë e ju mos e leni, bleni banesat". E në anën tjetër, na e kishim prej Zagrebi atje në lajme në mramje që i ndigjojshtim që mos jepni pare për sërëbët. E kanë qenë disa veprime të sindikatës të asaj kohe të cilat edhe nga kjo distancë kohore mendoj se kanë qenë të rrugës, të mira edhe e kanë ruajt pasurinë edhe private edhe shoqnore të Kosovës.

Anita Susuri: Cilat kanë qenë angazhimet e sindikatës, tjera, për me i ndihmu punëtorët? Konkretisht për shembull e dimë që kanë qenë disa organizime me shku me punu në Malishevë, familja e ndihmon familjen, kemi ndëgju për këto.

Burhan Kavaja: Osh't' një send interesant që ka pasë një ecuri humane, e cila jo veç për minatorë po posaçërisht për minatorë ka qenë në nivelin ma të lartë të mundshëm. Patëm shku në Malishevë une, Azizi edhe një pjesë e "Trepçës" me bisedu me ata që me i çu minatorët në punë, në pjesën e Dukagjinit. Ata përveç që patën pranë që m'i kyç minatorët aty, u patën deklarë se janë të gatshëm edhe me majt familje. Edhe patëm organizu qashtu, qashtu punën që ku kena shku, po thom ku kena shku se insistojshtim patjetër me ju parapri edhe Azizi edhe une.

Insistojshtim, na nuk dojshtim në atë kohë aq shumë me u kyç në ato rrjedha, për arsye se menojshtim që shumë shpejt do të zgjidhet edhe çashtja e tyne. Ku kena shku që na kanë prit, na kanë ndihmu edhe u patën lidh familja i ndihmon familjes edhe i ndihmojshtim xehëtarët me e tejkalu një situatë të vështirë. Ka pasë edhe që na kanë thirrë edhe kanë kërkim pajtimin e gjaqeve edhe aty kena shku besoj që kena arritë në disa vende do suksese të cilat meritojnë për ato treva me i përmend, po masi ka qenë ky grupi për pajtimin e gjaqeve kjo ka qenë minimale puna jonë.

Anita Susuri: A keni pasë edhe angazhim tjetër karshi qatij... karshi sindikatës, që jeni marrë në vitet e '90-ta? Si keni mbijetu?

Burhan Kavaja: Angazhimi personal i imi edhe i Azizit në atë kohë ka qenë pregaditja e kësaj librës {tregon para vetes}. Jena angazhu që me pasë sa ma të denjë, të saktë me shënime një libër e cila munet me ju shërby qe tash edhe juve edhe tjerëve. Na jena angazhu në dy-tre projekte, ato për vlerësimin e pasurisë natyrore po edhe në nivele ndërkombëtare për prezantimin e gjendjes së minatorëve në “Trepçe” pas dëbimit nga Serbia. Këto kanë qenë angazhimet tona permanente në atë kohë, besoj qe me plot, plot sukses e kena bo.

Po kena qenë të organizum me furnizimin edhe organizimin e UÇK-së. Mu më kujtohet djali punonte në atë kohë në ndërmarrje me konzervat të mishit, një kamion me ato konzervime që ju patëm çu UÇK-së në pjesën e Shalës Bajgorës. Edhe vet kena qenë dy-tri herë përveç në përkrahje t'u ofru edhe ndihmën tonë posaçërisht në rrethin e “Trepçës”, mbrojtjen e mundësive që mos të minohet “Trepça” ose mos të bombardohet, se kishte me qenë dëm i madh. Edhe mendoj se me sugjerimet tona personale osht' arritë, po kuptohet me angazhimin e tyre në rend të parë.

Anita Susuri: Gjatë gjithë luftës a keni qenë këtu?

Burhan Kavaja: Po. Krejt kohën.

Anita Susuri: Si ju ka kalu...

Burhan Kavaja: S'pari me tregu që kisha qenë me një regjistrim, regjistër për likvidim. Vjen Shkelzen Riza me më kërkua edhe nuk më gjen mu, po ju tregon këtyne në shpi... gjatë luftës, thotë, “E kom pa” t'u qajt {vendos duart te sytë}, “Burhanin në listë për likvidim”. Edhe na prej atij momentit me gjithë Azizin vendosëm t'i lëshojmë shtëpiat edhe të shkojmë. Kena shku te një shtëpi e Xhelal Spahisë, turk, edhe jena vendosë aty. Mirëpo, furnizimi me ushqim edhe qarkullimi që u bojke edhe na nuk rrijshim të mbyllun krejt kohën, marrin vesh se jena aty. Edhe kojshit serbë aty lajmërojnë.

Vijnë një natë, natën edhe i kapi i thejné dyrt edhe hijné mrenda. Kur hijné mrenda po ju tregojné komandës tyre se, “Këtu është Aziz Abrashi edhe Burhan Kavaja” edhe ka qenë edhe një njeri tjetër, “Çka me bo me ta?” Ata, po nihen në radiolidhje, po ju thojné, “*To su velike zveri*” ata janë shtazë të mëdha. Në kuptimin që s'duhet me na likvidu menjherë, po duhet me përdor për naj shkëmbim apo diçka tjetër. Aty na kontrollun, na morën do pare që i kishum ruajt, na majtën në gjendje shtetrrëthimit, ose të rrethimit, ose... qaq shumë e qaq keq sa që as ujë s'na lojshin me pi deri sa ngjau një gjë tjetër ma e madhe edhe i tërhjekën ata tu ju thonë, “Me shpejtësi duhet me shku këtu-këtu se ngjau diçka tjetër” kish kërsit dikush në polici e ata shkun, edhe ata shkun edhe na në njëfarë mënyre morrëm pakëz ajër që thojné, të lirë. Edhe u lirum prej tyre.

Anita Susuri: A jeni largu pastaj prej asaj shpisë, a?

Burhan Kavaja: Po jena largu në një shpi tjetër gjithashtu, mandej aty kena nejt një tri-katër ditë edhe une u ktheva përsëri në shpi. Po në shpi e kisha grunë edhe një djalë, një djalë ka qenë në Tiranë, ky i vogli, ai i madhi me telashe qishte. Kish pasë telashe shumë edhe pasojat ja kanë lonë edhe sot.

Anita Susuri: A ka pasë dhunë prej policisë a?

Burhan Kavaja: Gjithçka.

Anita Susuri: E lajmin për çlirimin e Prishtinës, kur kanë hi trupat e NATO-s, a keni qenë... sigurisht keni qenë aty në Prishtinë, si e keni prit këto?

Burhan Kavaja: Po, kom qenë me fillimin e bombardimit të NATO-s, drejt me të thonë po u krijojke një gjendje psikologjike asi lloji që gjithmonë po mendojshe që ty ka me të kalu edhe ty nuk të gjujnë ata {ngrit duart afër kokës}. Në afërsi krejt u bombardojke, krejt... drejt me të thonë unë nijsha kënaqësi edhe kur u bombardojshin rezervoarët e benzinës edhe Sekretariati i Punëve të Brendshme edhe objektet tjera, krejt... Këtu kom qenë, kom qenë edhe kur kanë hi rusët edhe kom qenë afërsisht ngat "Grandit" aty, kur hinën ata me tenka edhe atëhere sërëbët fillunë me festu, ata fillunë me gjujt me armë, edhe e kom përjetu edhe ate.

Anita Susuri: Çka keni menu ju kur i keni pa rusët?

Burhan Kavaja: Une e kom pasë njëfarë ndjenje për arsye se kur hinën NATO-ja, nimdhetë aeroplana prej aeroportit të Sllatinës jugosllavo-rus fluturun, ikën. Kom pasë një ndjenje se ata këtu i kanë bazat e veta. Mirëpo, s'ma ka marrë mendja që aq shpejtë mujnë me mrri edhe m'i ndërru uniformat edhe me ndrru armatimin fare. Isha i mendimit se me pasë qenë pakëz ma gjakftohtë Jacksoni, ka mujt me fillu edhe lufta edhe në asi rrethana zakonisht edhe fillojnë në njëfarë mënyre konfliktet e armatosuna. Këtë anë NATO-ja, në atë anë rusët edhe çka munët m'u prit për njerëzit? Mos të thom për ne popullatën në Prishtinë. Mirëpo, nuk ndodhi ajo fatbardhësisht.

Anita Susuri: Tash deshta zoti Burhan, me fol për periudhën e pasluftës edhe angazhimin e juj... Domethonë, e di që "Trepça" ka qenë në gjendje shumë të randë pasluftës edhe shumë vonë jonë inkuadru, domethonë stafi për me vazhdu punën. Ku jeni konë ju gjatë qesaj kohe edhe me çka jeni marrë ju?

Burhan Kavaja: Me 13 qershor, e kisha një veturë të vjetër, e mora grunë edhe u nisa në Stari Trg. Me 12 qershor, trupat e NATO-s u stacionun në Prishtinë me 13 qershor shkova në Stari Trg. Me 13 qershor kishin qenë marokianët aty edhe po ju thom, "Une jom ardhë 'Trepçën' me e vizitu, kom qenë këtu drejtor edhe me pa çfarë gjendje osht". Tha, "Na ty s'mujm me të lëshu". Edhe e thirrën komandën franceze edhe ata kuptohet nuk m'lëshun mu. Tentimi im një kohë të gjatë që patjetër ta rikthejmë "Trepçën" u bo me negociata me UNMIK-un. Një administrator i UNMIK-ut na mundësoi që me shku për një muj ditë me bo një raport për "Trepçën". Tha, "Une po ju shti ka dritaret ju hapne derën". Edhe qashtu ndodhi edhe ai na shtini.

Une shkova me një ekip prej 200 vetëve në "Trepçe" të pregaditun paraprakisht për secilin çka ka me bo. Patëm kohë një disa ditë m'u pregaditë. Edhe shkum, fillum, kur hijshum mrena KFOR-i na

hallakatke, a mrena na e kishim eksplozivin e vjetër. Ashtu ka ndodh 28 ditë në kontroll të armatosun me 200 vetë, me vizitu minierën. Aty kena gjetë tragje të dhunimit, kena gjetë tragje të keqpërdorimeve, vjedhjeve të cilat i lajmrum edhe kanë ardhë i kanë fotografu. Pasi e pregaditëm raportin detalisht, e dorëzëm në UNMIK edhe ja dorëzëm qeverisë të përkohshme. A mendoni që qeveria e përkohshme e ka kqyr ato? S'ka ditë as me kqyrë, as me pa. UNMIK-u e studioi atë punë krejt edhe na mundësoi që me vazhdu edhe pak pjesën e minierës.

Patëm lajmru na protestë, mirëpo esenca profesionale e jona ishte të rujmë në minierën prej zhytjes, gjegjësisht fundosjes prej ujit, se kishum pesë-gjashtë kubik ujë në minutë, që mundke me fundos. Edhe na vyjshin thasët me bo barazh edhe u lajmërova te gjenerali francez me kërkesë që të na jep do thasë edhe do material që ta bojmë një barazhë. Ai tha, “Eja të bisedojmë”. Shkova me bisedu me gjeneralin francez, të gjitha i kom të shënume. Më tha, “Po, t’i jepi ushtarët une, me thasë e me krejt. Mirëpo, kërkoj prej teje m’i nalë protestat”. Thashë, “Zotni une s’kom lidhje me protesta, ato i realizojnë këto njësitë tjera të ‘Trepçës’, që po lypet kthimi në punë”. Tha, “Une po të thom ty në qoftë se i don thasët që mos me t’u fundos miniera nali protestat”.

Edhe qetash ma dha me dije se ndikimi yt mundet m’i ndalë, në atë kuptim. Edhe une erdha edhe po ju thom këtyne, “Kqyre na duhet m’i nal këto protestat për arsye se po më vyn për minierë thasët, me mbrojt minierën”. Edhe qashtu ndodhi ata m’i çunë thasët edhe e mbrojtëm minierën edhe arritëm që minierën edhe kur e lirim komplet me qenë e mbrojtne, mos me qenë e fundosne se kishte me qenë e shkatërrume. Domethonë, aktiviteti im mas luftës ka qenë ky. Fillova me punu përsëri mandej në minierë. Problemet ma të mëdha i kisha për mjete për investime. UNMIK-u na ndihmoi me njëqind mijë euro për pompa dhe pjesët rezervë për paisje. Me një numër të jashtëzakonshëm entuziastësh arritëm me pregaditë minierën për prodhim. Këta e prunën ekipën tjetër, na ndërrun neve, qeveria e përkohshme në krye me Thaçin, na hiqën prej atyhit i prunë tjerët edhe ia nisën me plot sukses me shkatërru.

Anita Susuri: E përmendët edhe një pjesë që e lamë pa e mbulu, ke greva që e kanë bo... greva e dytë ke, sa jeni konë ju në burg, domethonë i burgosun, çka mani në mend prej qasaj dhe çka keni ndëgju për ato se qysh ka shku ajo grevë?

Burhan Kavaja: Ajo ka qenë një grevë e cila komplet ju ka përkushtu shokëve të vet të burgosun, tu i përfshi të gjithë për lirimin e tyne. Grevë e cila osht’ arritë m’u nalë me njësi speciale të Beogradit me Baxhën, e paraprakisht ju kanë dhonë bukë të nxehtë me sedativ. Edhe i kanë pru në gjendje të vështirë mendore dhe kanë hi i kanë lidhë me tela edhe i kanë qit’ jashtë. Ajo ka qenë një grevë në përkrahje të shokëve të tyne, si grevë solidare me atë grevën e parë. Edhe në njifarë mënyre qeshtu ka vepru Serbia me gjithë ata, me dhunë. Mandej, i kanë emëru drejtorët serbë aty, njifarë Novako Beliqin, i cili ka punu me gjithë tjerë, me bullgarë edhe me tjerë t’u angazhu në “Trepçe” në shfrytëzimin jo racional të lëndëve të para. Edhe me shkatërrimin e asaj si sot është në gjendje jashtëzakonisht të fshtirë, po pa të keqen edhe këtyne që po e shkatërrojnë.

Anita Susuri: E në cilën kohë u zhvillu qekjo, po mendoj në çfarë date ka qenë qajo greva e dytë që u zhvillu, afërsisht nëse e dini?

Burhan Kavaja: Më duket ka qenë në gusht dikun '90-shës. Jo ka qenë, jo ka qenë përpara, ka qenë para... në fillim të vitit kur jena lëshu na, domethonë ka qenë në fund të vitit '89-shës.

Anita Susuri: Zoti Burhan, nëse keni edhe diçka që doni me shtu për fund...?

Burhan Kavaja: Momentalisht nuk po më kujtohet. Po juve shumë falemnderës për këtë durim...

Korab Krasniqi: E kam një pyetje krejt në fund nëse nuk e ka problem. Me Azizin më duket që keni kalu faza e faza bashkarisht edhe e cekët që ka ma shumë se gjashtë vjet që ka vdekë.

Burhan Kavaja: Po.

Korab Krasniqi: Qysh e keni përjetu vdekjen?

Burhan Kavaja: Në mbledhjen komemorative e cila u mbajt në kinemanë "ABC", e pata pregaditë një *in memoriam* për te, që në pjesën kur thashë, "Kur të më pyetin, 'Ku e ka Azizin?' Ç'a t'ju thom?" Krejt salla ja ka fillu me qajt. E kom përjetu shumë rond, s'kom qenë këtu kur ka vdekë, po djali tij ma çon një mesazh edhe më thotë, "Axha Burhan, baba ka vdekë. T'kish konsideratë se ki me marrë rrugë, ruju rrugës" (flet i përletur). Shumë rondë e kom përjetu vdekjen e tij edhe sot më mungon.

Anita Susuri: Falemnderit shumë edhe një herë!

Korab Krasniqi: Falemnderit shumë zoti Burhan!

Anita Susuri: Falemnderit!